



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE
KRIMIN E ORGANIZUAR

Nr. Regj. Them. 60
Dt. Regj. 29.06.2021

Nr. 60 Vendimi
Dt. 27.07.2021

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me trup gjykues të përbërë nga:

GJYQTAR - ERJON ÇELA

Sot në dt. 27.07.2021, pasi mori në shqyrtim, në dhomë këshillimi pa praninë e palëve dhe të sekretares gjyqësore kërkesën penale me Nr. 60 Akti, me palë :

KËRKUES : Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e përfaqësuar sipas kërkesës nga prokurori **Klodian Braho** (në mungesë).

OBJEKTI : Revokimi i vendimit të pushimit të çështjes penale në ngarkim të shtetasit Fatmir Mediu, e pushuar me vendimin nr. 6, dt. 14.09.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE : Nenet 288 e, 329/c të Kodit të Procedurës Penale, si dhe neni 73 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Gjykata, në zbatim të nenit 329/c pika 3 të K.Pr.Penale, pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën penale, si shqyrtoi aktet dhe çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. Rrethanat procedurale dhe faktike të çështjes.

1. Me vendimin nr. 1, dt. 01.06.2021 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë¹ ka përcaktuar Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si gjykatë kompetente për të shqyrtuar çështjen penale me palë dhe objekt si më poshtë: Kërkues - Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Objekti – “*Revokimi i vendimit të pushimit të çështjes penale në ngarkim të shtetasit Fatmir Mediu, e pushuar me vendimin nr. 6, dt. 14.09.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*”.

2. Gjykata, çmon që të theksojë paraprakisht se përcaktimi i kompetencës lëndore të gjykatës për gjykimin e një mosmarrëveshje është një element shumë i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor. Në lidhje me rëndësinë e përcaktimit të kompetencës lëndore Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 11 dt. 23.04.2009 ndër të tjera ka theksuar : “... *shqyrtimi i një çështje nga një gjykatë jo kompetente nuk përbën në çdo rast vetëm një shkelje procedurale, por ka të bëjë edhe me respektimin e të drejtës kushtetuese për tu gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Marrja nga një gjykatë e kompetencës që i takon me ligj një gjykatë tjetër, mund të bëhet vetëm nëse e lejon ligji dhe vetëm nga gjykatat që ai cakton. ... Mosrespektimi i kompetencës lëndore e bën vendimin gjyqësor absolutisht të pavlefshëm ...*”.

3. Në lidhje me kompetencën lëndore, Gjykata e Lartë në vendimin e sipërcituar ndër të tjera ka arsyetuar se : ... 40. *Referuar kuadrit ligjor të mësipërm, Kolegji vlerëson se Gjykata e Lartë nuk ka më juridiksion fillestar për të shqyrtuar akuzat penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë, pasi që prej ndryshimeve të miratuara me ligjin nr. 76/2016 dhe nr. 35/2017 kompetencën për të shqyrtuar këto akuza penale e ka Gjykata për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Gjithashtu, referuar ndryshimeve që ka pësuar neni 329/a e vijues i K.Pr.Penale, rezulton se kërkesa për pushim si dhe revokimi i vendimit të pushimit janë në kompetencën e gjyqtarit të seancës paraprake. Duke qenë se kompetencën lëndore për shqyrtimin e çështjes penale në themel e ka Gjykata për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Kolegji vlerëson se kjo gjykatë ka kompetencën lëndore për t'u shprehur edhe në lidhje me kërkesën për revokim të vendimit të pushimit, e cila do të duhet të shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake pranë kësaj gjykatë. ... 44. Në vijim të arsyetimit të mësipërm, Kolegji vlerëson se Gjykata e Lartë nuk ka kompetencë lëndore për të marrë në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Prokuroria e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me objekt revokimin e vendimit të pushimit të çështjes penale në ngarkim të shtetasit Fatmir Mediu, e pushuar me vendimin nr. 6, datë 14.09.2009, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, prandaj Kolegji vendos të shpallë moskompetencën lëndore dhe t'ia dërgojë aktet Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.*

4. Duke qenë kështu, Gjykata konstaton se ka juridiksionin dhe kompetencën lëndore për gjykimin e kësaj çështje penale, kjo pasi Gjykata e Lartë me vendimin nr. 1, dt. 01.06.2021 e ka përcaktuar Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e

¹ Me vendimin nr. 1, dt. 01.06.2021 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur: “1. *Deklarimin e moskompetencës lëndore për shqyrtimin e kërkesës penale nr. 000-0001-2021 dt. 05.05.2021. 2. Dërgimin e akteve Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar*”.

Organizuar si gjykatë kompetente për të shqyrtuar çështjen penale. Në lidhje me këtë çështje, Gjykata sjell në vëmendje edhe përcaktimin e nenit 86 pika 2 të K.Pr.Penale me titull “Vendimi i gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë mbi kompetencën” sipas së cilit : “Vendimi i Gjykatës së Lartë mbi kompetencën është i detyrueshëm, përveç rasteve kur dalin fakte të reja që çojnë në një përcaktim të ndryshëm juridik, nga i cili bëhet kompetente një gjykatë më e lartë”.

5. Në zbatim të nenit 329/c² dhe 13/2 shkronja “c”³ të K.Pr.Penale, Gjykata e shqyrtoj kërkesën penale objekt gjykimi (*kërkesë për revokimin e vendimit të pushimit*) me një gjyqtar të vetëm në cilësinë e gjyqtarit të seancës paraprake.

6. Nga aktet procedurale dhe provat pjesë e fashikullit të prokurorisë që lidhen me çështjen konkrete rezultojnë të provuara këto fakte : Në datën 15.03.2008, në ambientet e ish - Brigadës së Tankeve, në fshatin Gërdec, Tiranë, ku ushtronte aktivitetin e çmilitarizmit dhe çmontimit të municioneve luftarake shoqëria “Albademil” sh.p.k, ndodhën një seri shpërthimesh masive që sollën pasoja të rënda. Si rezultat i kësaj ngjarjeje u shkaktua vdekja e 26 personave, plagosja e rëndë e 27 personave, plagosja e lehtë e 109 personave, dëmtime të parëndësishme në 67 persona, si dhe dëmtime të tjera të paklasifikuara të 61 personave që janë trajtuar në spitale e qëndra shëndetësore. Nga kjo ngjarje u shkaktua dëm në pasuri shtetërore e private në vlerën 2.243.843.616 lekë.

7. Në kuadër të kësaj ngjarjeje, Prokuroria e Përgjithshme regjistroi procedimin penal nr. 3, të vitit 2008, në ngarkim të të pandehurit Fatmir Mediu (*në cilësinë e ish – Ministrit të Mbrotjtjes njëherësh dhe deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë – më vijim Kuvendi*), duke e akuzuar për veprat penale “*Shpërdorimi i detyrës*” në bashkëpunim, parashikuar nga nenent 248 - 25 të Kodit Penal dhe “*Shpërdorimi i detyrës*” në bashkëpunim, me subjekt ushtarak - kuadër komandues, parashikuar nga nenet 70/2 e 2 të Kodit Penal Ushtarak dhe 25 i Kodit Penal, si dhe në ngarkim të të pandehurve Agim Lala, Ndue Marku, Ardian Mullai, Zija Bahja, Luan Hoxha, Zenun Fero, Hysni Cocka, Lavdi Shatro, Jorgo Mino, Fiqiret Mato, Armand Tartari, Fatbardh Kuci, Shpetim Spahiu, Adriatik Mema, Rezart Tershana, Denis Hajdari, Gëzim Hoshafi, Besnik Dauti, Agim Babameto, Fahri Toska, Mihal Delijorgji, Ylli Pinari, etj.

8. Në fazën e hetimeve paraprake, Prokurori i Përgjithshëm i kërkoi Kuvendit autorizimin për procedim penal ndaj shtetasit Fatmir Mediu, i cili në atë kohë ushtronte

² Neni 329/c i K.Pr.Penale me titull “Revokimi i vendimit të pushimit” përcakton: “Kur pas vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes dalin ose zbulohen të dhëna apo prova të reja, të cilat tregojnë se vendimi nuk është i bazuar, ai mund të revokohet nga gjyqtari i seancës paraprake me kërkesë të prokurorit, të viktimës ose trashëgimtarëve të saj. Kërkesa, së bashku me aktet dhe provat e reja, depozitohet në sekretarinë e gjykatës.2. Kërkesa shoqërohet me provat e reja me pasojë mospranimi. 3. Kërkesa shqyrtohet në dhomë këshillimi. Kur vendos pranimin e kërkesës, gjykata revokon vendimin e pushimit dhe i kthen aktet prokurorit, i cili rifillon hetimet. 4. Në përfundim të hetimeve, kur nuk procedon sipas neneve 328, 329/a, 406/a ose 406/dh, të këtij Kodi, prokurori paraqet në gjykatë kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq”.

³ Neni 13/2 shkronja “c” i K.Pr.Penale përcakton : “Gjykatat e rretheve gjyqësore dhe Gjykata e Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykojnë me një gjyqtar : ... c) kërkesa e prokurorit për pushimin e akuzës ose çështjes për krimet. ...”.

funksionin e Ministrit të Mbrojtjes dhe njëherazi edhe deputet në legjislaturën e XVII të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Ky autorizim u dha nga Kuvendi me vendimin nr. 185, datë 16.06.2008⁴.

9. Pas kryerjes së të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme, në përfundim të hetimeve paraprake, Prokuroria e Përgjithshme vendosi që të dërgojë për gjykim në Gjykatën e Lartë⁵ procedimin penal nr. 3 të vitit 2008 në ngarkim të 31 të pandehurve, mes të cilëve edhe për të pandehurin Fatmir Mediu duke e akuzuar për veprat penale të pasqyruara si më sipër⁶.

10. Gjatë gjykimit të kësaj çështje, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin e datës 22.05.2009, (vendim i ndërmjetëm për kërkesat paraprake) vendosi : “1. Shpalljen e moskompetencës së Gjykatës së Lartë për gjykimin e akuzave penale në ngarkim të të pandehurve Agim Lala, Ndue Marku, Ardian Mullai, Zija Bahja, Luan Hoxha, Zenun Fero, Hysni Cocka, Lavdi Shatro, Jorgo Mino, Fiqiret Mato, Armand Tartari, Fatbardh Kuci, Shpetim Spahiu, Adriatik Mema, Rezart Tershana, Denis Hajdari, Gëzim Hoshafi, Besnik Dauti, Agim Babameto, Fahri Toska, Mihal Delijorgji, Ylli Pinari, Shkëlzen Madani, Ardian Mullai, Sokol Ngjeci, Dritan Minxholli, Juljana Margariti, Dashnor Caushi, Hilmi Lacaj e Shoqëria “Albademil” sh.p.k. dhe dërgimin e çështjes në ngarkim të tyre për kompetencë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. 2. ...”. Referuar pjesës arsyetuese të këtij vendimi, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vendosi që të ndajë çështjen penale në ngarkim të të pandehurve të tjerë Agim Lala, Ndue Marku etj. dhe të vazhdojë gjykimin vetëm ndaj të pandehurit Fatmir Mediu për shkak se ai ishte subjekt i gjykimit të akuzave penale nga ky Kolegj, konform dispozitës së nenit 141/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që ka qënë në fuqi në kohën e gjykimit.

11. Gjatë kohës që çështja ishte në shqyrtim në Gjykatën e Lartë (në fazën e paraqitjes së kërkesave paraprake), në datën 28.06.2009 në Republikën e Shqipërisë u mbajtën zgjedhjet parlamentare ku rezultoi se i pandehuri Fatmir Mediu u rizgjodh përsëri deputet në legjislaturën e XVIII të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Duke mbajtur parasysh këtë fakt (i pandehuri ka rimarë përsëri mandatin e deputetit) mbrojtësit e të pandehurit Fatmir Mediu kërkuan para Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë pushimin e çështjes penale në ngarkim të tij për shkak se jemi para njërit prej rasteve të parashikuar nga ligji⁷ që nuk lejon vazhdimin

⁴ Me vendimin nr. 185, dt. 16.06.2008 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka vendosur: “Dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj deputetit Fatmir Mediu, kërkuar nga Prokurori i Përgjithshëm. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë”.

⁵ Procedimi penal nr. 3 i vitit 2008 i Prokurorisë së Përgjithshme u dërgua për gjykim në Gjykatën e Lartë për shkak se i pandehuri Fatmir Mediu ishte subjekt i gjykimit të akuzave penale nga kjo gjykatë sipas nenit 141/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që ka qënë në fuqi në kohën e zhvillimit të këtij gjykimi sipas të cilit përcaktohej : “1.Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar dhe rishikues. Ajo ka juridiksion fillestar kur gjykon akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, deputetëve, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. 2...”.

⁶ Shiko pikën nr. 7 të pjesës arsyetuese të vendimit.

⁷ Neni 73/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i cili ka qënë në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes përcaktonte: “... 2.Deputeti nuk mund të ndiqet penalisht pa autorizimin e kuvendit. Autorizimi kërkohet edhe në rastin kur ai do të arrestohet. ...”.

e procedimit penal (pasi organi i akuzës nuk ka paraqitur kërkesë për autorizim para Kuvendit për të lejuar ndjekjen penale).

12. Në bazë të kësaj kërkesë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 6, datë 14.09.2009, ka vendosur : *“Pushimin e procedimit penal në ngarkim të të pandehurit Fatmir Mediu, për shkak se ndjekja penale ndaj tij nuk mund të vazhdojë”*. Në vendimin e sipërcituar Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ndër të tjera ka arsyetuar: *”... Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, nga provat e administruara në seancën gjyqësore të datës 14.09.2009, konstaton se ndjekja penale ndaj të pandehurit Fatmir Mediu nuk mund të vazhdojë. Ai prej datës 1.8.2009 është zgjedhur deputet dhe pasi ka marrë këtë mandat kushtetues, Kuvendi i Shqipërisë nuk ka lëshuar autorizim për ndjekjen e tij penale. Autorizimi që ndodhet në dosjen hetimore mban datën 16.06.2008 dhe është i lëshuar nga Kuvendi i Shqipërisë, në Legjislaturën e XVII-të të tij, ndërkohë që i pandehuri Fatmir Mediu është deputet i Legjislaturës së XVIII-të të Kuvendit të Shqipërisë. Do të ishte antikushtetues vazhdimi i procedimit penal ndaj të pandehurit Fatmir Mediu me pretendimin se autorizimi i datës 16.06.2008 vlen edhe mbas datës 1.8.2009, pasi me këtë arsyetim do të pranohet faktin se mandatin e deputetit ky i pandehur e ka fituar pa imunitet parlamentar. Natyrisht, ky mandat nuk mund të ishte i pjesshëm, sepse imuniteti i deputetit të sapo zgjedhur është element përbërës i statusit të tij dhe mund të hiqet vetëm në seancë plenare të Kuvendit dhe me një procedurë të caktuar posaçërisht në rregulloren e Kuvendit. Përforcimi kushtetues i mandatis të deputetit me një imunitet kundër ndjekjes penale, është një akt sovran, të cilin zgjedhësit e kanë parasysh kur votojnë një kandidat për deputet. Në ushtrimin e kësaj prerogative politike zgjedhësit nuk mund të kufizohen nga një akt i Kuvendit të mëparshëm, sepse imuniteti i hequr nuk ndalon as rikandidimin e as zgjedhjen si deputet të personit të cilit i është hequr më parë imuniteti. Kjo është një nga rrjedhojat e rëndësishme të mbrojtjes politiko-kushtetuese të deputetit, që e dallon atë nga shtetasit e zakonshëm. Akti i zgjedhjes dhe konfirmimi i mandatis të deputetit nga Kuvendi i sapozgjedhur në seancën e tij të konstituimit është një akt i plotë dhe as në teorinë e as në praktikën kushtetuese nuk njihen raste që ky akt të jetë i privuar nga elementet e tij thelbësore, siç është ndër të tjera imuniteti kundër ndjekjes dhe procedimit penal. E kundërta do ta bënte këtë akt të pavlefshëm nga pikëpamja kushtetuese dhe do t'i hapte rrugën ndjekjes penale kundër deputetëve në kundërshtim me dispozitat ushtetuese (N.73/2) dhe ato të K.Pr.Penale (N.288), duke i zhvleftesuar këto në qellimin për të cilin janë parashikuar të veprojnë. Organi i akuzës nuk mund të mbështetet në kërkimin e vazhdimit të gjykimit kundër të pandehurit mbi bazën e një autorizimi të lëshuar nga Kuvendi i mëparshëm, sepse ky autorizim për nga vetë natyra e tij është i kufizuar në kohë. Ky autorizim bie dhe zhvishet nga efektet jo vetem për shkak panevojshmërie kur gjykata jep vendim themeli, por edhe kur i pandehuri gjatë gjykimit rifiton një mandat të rregullt parlamentar. Për shkak se imuniteti është garanci e Kuvendit si institucion dhe jo e deputetit të tij, vazhdimi i gjykimit kundër të pandehurit do të cënonte vetë integritetin e Kuvendit, i cili është vetë ai që mund të vendosë për heqjen e këtij imuniteti mbi një kërkesë të posaçme, vetëm të organit të akuzës. Mungesa e autorizimit për ndjekjen penale të të pandehurit Fatmir Mediu, e ndalon gjykatën të*

vazhdojë ndjekjen penale në ngarkim të tij, ndalim i cili është parashikuar shprehimisht në dispoziten e nenit 290 të K.Pr.Penale ku në piken “e” përcaktohet se: “Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe, në qoftëse ka filluar duhet të pushojë në çdo gjendje të procedimit ... në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga ligji.”. Një prej këtyre rasteve pa dyshim është ndalimi i ndjekjes penale të deputetit pa autorizimin e Kuvendit, ndalim që është parashikuar shprehimisht në ligjin themeltar të shtetit në nenin 73/2 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe në nenin 288/1 të K.Pr.Penale. ... Gjithashtu Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon se ai ndodhet në pamundësi procedurale për t'i kërkuar Kuvendit të Shqipërisë autorizimin për vazhdimin e ndjekjes penale të të pandehurit Fatmir Mediu. Nga përmbajtja e dispozitës së nenit 288/1 të K.Pr.Penale sipas të cilit: “Kur parashikohet autorizimi për procedim, prokurori bën kërkesën në organin përkatës”, rezulton se të drejtën për të kërkuar këtë autorizim e ka vetëm prokurori”.

13. Në vitin 2011, Shoqata e Familjarëve të viktimave të Shpërthimit Gërdecit, pas refuzimit të kërkesës nga organi i akuzës (Prokuroria e Përgjithshme) që të niste edhe një herë procedimin ndaj shtetasit Fatmir Mediu i është drejtuar Gjykatës së Lartë duke kërkuar: “Dhënien e informacionit dhe procedimin e fajtorit”. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 9, dt. 13.06.2011 ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës së bërë nga Shoqata e Familjarëve të Viktimave Shpërthimit të Gërdecit, sit ë pa bazuar në prova dhe në ligj”. Në këtë vendim Gjykata e Lartë ndër të tjera ka arsyetuar: “... Gjykata e Lartë ka vendosur pushimin e procedimit penal në ngarkim të të pandehurit Fatmir Mediu, për shkak të mungesës së autorizimit për procedim, të cilin ajo është kompetente ta kërkojë vetëm në rastin e veprave penale të parashikuara nga neni 59 i K.Pr.Penale, për të cilat lejohet ankimi i drejtëpërdrejtë në gjykatë. Për veprat e tjera penale, autorizimi për procedim mund të kërkojë vetëm nga prokurori, i cili sipas nenit 292 të K.Pr.Penale nuk ka asnjë pengesë ligjore për ushtrimin e ndjekjes penale për të njëjtin fakt dhe të njëjtin person, nëse i jepet autorizimi nga organi kompetent, ose në momentin që zhduket kushti personal-që e bën të domosdoshëm autorizimin” (bie imuniteti për shkak të mos qenit më deputet), mund të rifillojë përsëri ndjekjen penale. Duke arsyetuar si më sipër, Kolegji Penal arrin në përfundimin që kërkesa e paraqitur nga Shoqata e Familjarëve të Viktimave të Shpërthimit të Gërdecit është e pa bazuar në prova dhe në ligj, prandaj si e tillë ajo duhet të rrëzohet”.

14. **Nga sa u pasqyrua më sipër, Gjykata çmon që të evidentojë se edhe pse Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në të dy vendimet e tij ka theksuar se të drejtën për të kërkuar autorizimin për procedim sipas ligjit e ka vetëm prokurori⁸, nga tërësia e akteve procedurale dhe e provave që ndodhen në dosjen gjyqësore konstatohet se që prej datës 14.09.2009 (data e shpalljes së vendimit të pushimit nga Gjykata e Lartë) e në vazhdim, organi i akuzës nuk i kërkojë përsëri Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhënien e**

⁸ Neni 288/1 i K.Pr.Penale me titull “Autorizimi për të proceduar” i cili ka qënë në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes përcaktonte: “1. Kur parashikohet autorizimi për procedim, prokurori bën kërkesë në organin përkatës. 2 ...”.

autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj ish - deputetit Fatmir Mediu, mungesa e të cilit nuk lejonte vazhdimin e procedimit penal.

15. Me ligjin nr. 88/2012 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, dt. 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjvënësi e ndryshoi përmbajtjen e nenit 73 paragrafi 2 të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite kushtetuese tashmë të ndryshuar përcaktohet : “ ... 2. Deputeti nuk mund të arrestohet ose ti hiqet liria në çfarëdo lloj forme apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e Kuvendit. ... ”. Ndryshimi i nenit 73/2 të Kushtetutës si më sipër, solli edhe ndryshimet përkatëse ligjore⁹ që ju bënë dispozitave procedurale penale, më konkretisht nenit 288/1 të K.Pr.Penale sipas së cilit tashmë prokurori kërkon autorizim nga Kuvendi vetëm kur ndaj një deputeti duhet të cakohet masa e sigurimit “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi”, heqja e lirisë në çfarëdo lloj forme, kontrolli personal ose i banesës por jo për ushtrimin e ndjekjes penale ndaj deputetit apo për gjykimin e tij. Nga interpretimi i këtyre dispozitave kushtetuese dhe ligjore procedurale penale përcaktohet qartësisht se imuniteti parlamentar i deputetit gjen zbatim vetëm për caktimin e masave të sigurimit (arrest në burg ose arrest në shtëpi), heqjen e lirisë në çfarëdo lloj forme, kontrollin personal ose të banesës. Pra, me ndryshimet që iu bënë kushtetutës me ligjin nr. 88/2012 deputeti i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nuk gëzon imunitet parlamentar për ndjekjen penale apo gjykimin e tij. Gjithashtu me ligjin nr. 35/2017 pësoi ndryshime edhe neni 292 i K.Pr.Penale¹⁰ i cili aktualisht nuk e parashikon më mundësinë e rifillimit të ndjekjes penale kur është vendosur pushimi i çështjes për shkak se mungon autorizimi për procedim.

16. Edhe në këtë moment, Gjykata cmon që të evidentojë se edhe pse kuadri kushtetues dhe ligjor përcakton se deputeti nuk gëzon imunitet parlamentar për ndjekjen penale apo gjykimin e tij konstatohet se që prej vitit 2012¹¹ e në vazhdim (më shumë se 8 vjet), organi i akuzës përsëri nuk ndërmori hapat e nevojshëm sipas ligjit për ushtrimin e ndjekjes penale megjithëse tashmë nuk ishte më e nevojshme që të kërkohej të jepej autorizimi nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

⁹ Neni 288/1 i K.Pr.Penale ka pësuar ndryshimet përkatëse me miratimin e ligjit nr. 21/2014, dt. 10.03.2014 dhe më pas me miratimin e ligjit nr. 35/2017 ndryshime të cilat janë në fuqi dhe aktualisht. Teksti i nenit 288/1 të K.Pr.Penale i zëvendësuar me ligjin nr. 21/2014, datë 10.3.2014 ishte: “1. Në rastet e arrestit, heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, ushtrimit të kontrollit personal ose të banesës së deputetit, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarit të Gjykatës së Lartë apo gjyqtarit, prokurori bën kërkesë në organin përkatës. ...”. Teksti i nenit 288/1 të K.Pr.Penale i zëvendësuar me ligjin nr. 35/2017, datë 10.3.2014 i cili është në fuqi dhe aktualisht: “1. Kur ndaj një deputeti duhet të caktohet masa e sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, heqja e lirisë në çfarëdo lloj forme, kontrolli personal ose i banesës, prokurori kërkon autorizim nga Kuvendi. ...”.

¹⁰ Neni 292 i K.Pr.Penale i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017 përcakton: “Vendimi i mosfillimit të procedimit ose i pushimit, të dhënë për shkak të mungesës së ankimit, nuk pengojnë kryerjen e hetimeve për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtit person, në qoftë se më pas bëhet ankim”, ndërsa teksti i mëparshëm përcaktonte: “1. Vendimi i mosfillimit të procedimit, i pushimit ose i pafajësisë, të dhënë për shkak të mungesës së ankimit për procedim ose të kërkesës së autorizimit për procedim, nuk pengojnë ushtrimin e ndjekjes penale për të njëjtin fakt dhe kundër të njëjtit person, në qoftë se më pas bëhet ankimi, jepet autorizimi ose zhduket kushti personal që e bënte të domosdoshëm autorizimin”.

¹¹ Viti kur me ligjin nr. 88/2012 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, dt. 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjvënësi i hoqi deputetit imunitetin parlamentar për ndjekjen penale apo gjykimin e tij.

17. Në datën 26.02.2021 shtetasit Feruzan Durdaj dhe Zamira Durdaj (*në cilësinë e trashëgimtarëve të viktimës E.D i cili ka humbur jetën në moshën 7 vjeçare në ngjarjen e dt. 15.03.2008 në Gërdec*) i janë drejtuar Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me një kërkesë e cila rezulton që të jetë protokolluar me nr. 175 prot.. Me anën e kësaj kërkesë shtetasit Feruzan Durdaj dhe Zamira Durdaj i kërkojnë organit të akuzës që të vijojë me ushtrimin e ndjekjes penale ndaj shtetasit Fatmir Mediu pasi tashmë nuk ekziston më pengesa ligjore që konstatoi Gjykata e Lartë (*mungesa e autorizimit për procedim*).

18. Në bazë të kësaj kërkesë të trashëgimtarëve të viktimës, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesën penale objekt gjykimi ku ka kërkuar: *“Revokimin e vendimit të pushimit të çështjes penale në ngarkim të shtetasit Fatmir Mediu, e pushuar me vendimin nr. 6, dt. 14.09.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë”*.

19. Me vendimin nr. 1, dt. 01.06.2021 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur: *“1. Deklarimin e moskompetencës lëndore për shqyrtimin e kërkesës penale nr. 000-0001-2021 dt. 05.05.2021. 2.Dërgimin e akteve Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”*.

20. Në kërkesën penale objekt gjykimi Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ndër të tjera pretendon se : *“... ekzistojnë të gjitha shkaqet ligjore për revokimin e vendimit të pushimit të çështjes penale ndaj shtetasit Fatmir Mediu, pushuar me vendimin nr. 6 datë. 14.09.2009, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. ... vendimi i pushimit të çështjes ndaj shtetasit Fatmir Mediu është marrë në bazë të nenit 73/2 të Kushtetutës dhe neneve 290/1/e dhe 387/1 të K.Pr.Penale, sipas përmbajtjes së dispozitës kushtetuese dhe atyre procedurale në vitin 2009. Shkaku ligjor për të cilin është vendosur vendimi i pushimit është mungesa e autorizimit të Kuvendit për fillimin e ndjekjes penale ndaj shtetasit Fatmir Mediu, autorizim që sipas vendimit gjyqësor duhet të ishte kërkuar nga Prokuroria e Përgjithshme pas zgjedhjes së Fatmir Mediut deputet në legjislaturën e XVIII të Kuvendit të Shqipërisë, autorizim që nuk është kërkuar dhe nuk është dhënë nga Kuvendi. Ky shkak është vlerësuar nga Kolegji si një nga “rastet e tjera të parashikuara nga ligji” për të cilin ndjekja penale nuk mund të fillojë dhe nëse ka filluar duhet të pushojë në kuptim të nenit 290/1/e të K.Pr.Penale. Vendimi për pushimin e çështjes penale është marrë në fazën e kërkesave paraprake të procesit gjyqësor në ngarkim të shtetasit Fatmir Mediu, kërkesa të paraqitura në bazë të nenit 354/1 të K.Pr.Penale, para deklarimit të hapur të shqyrtimit gjyqësor në kuptim të nenit 355 të K.Pr.Penale. Në këtë gjykim Kolegji Penal nuk ka çelur shqyrtimin gjyqësor, nuk ka lejuar marrjen e provave të kërkuara nga prokurorët e çështjes apo mbrojtësit e të akuzuarit, nuk ka shqyrtuar provat dhe nuk ka kryer vlerësim të provave. Kolegji Penal nuk ka marrë vendim mbi ekzistencën ose jo të veprave penale për të cilat është akuzuar shtetasi Fatmir Mediu dhe mbi fajësinë ose jo të tij. Vendimi i pushimit të çështjes është marrë duke u bazuar vetëm në shkaqe procedurale, pa u gjykuar çështja penale në themelin e saj. Në këtë rast, shtetasi Fatmir Mediu "nuk është gjykuar me vendim të formës*

së prerë” në kuptim të nenit 7 të K.Pr.Penale. Njëkohësisht, revokimi i vendimit të pushimit dhe gjykimi në themel i akuzave dhe fajësisë së shtetasit Fatmir Mediu nuk mundet të konsiderohet se ai “gjykohet sërish” në kuptim të nenit 34 të Kushtetutës pasi çështja penale ndaj tij ende nuk është gjykuar në themel nga gjykata kompetente. Me ligjin nr. 88/2012 ka ndryshuar përmbajtja e nenit 73, paragrafi (2) i Kushtetutës, ku është parashikuar se: “Deputeti nuk mund të arrestohet ose t'i hiqet liria në çfarëdo lloj forme apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e Kuvendit”. ... Bazuar në këto dispozita kushtetuese dhe procedurale penale, ... deputeti nuk ka më imunitet parlamentar për ndjekjen penale ndaj tij, për hetimin apo për gjykimin e tij. Sipas kuadrit kushtetues dhe ligjor aktual, Prokuroria mundet që të fillojë hetimet dhe të kryejë hetime ndaj një deputeti, të vendosë marrjen të pandehur dhe njoftimin e akzuës, të kërkojë caktimin e një mase sigurimi të ndryshme nga ato të parashikuara në nenet 237 dhe 238 të K.Pr.Penale, të paraqesë kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq ndaj deputetit dhe në gjykatë të zhvillohet procesi gjyqësor ndaj tij, pa qënë e nevojshme që të kërkohet autorizimi apo të jepet autorizimi nga Kuvendi i Shqipërisë. Në nenin 329/c të K.Pr.Penale është parashikuar se: “Kur pas vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes penale dalin ose zbulohen të dhëna apo prova të reja, të cilat tregojnë se vendimi nuk është i bazuar, ai mundet të revokohet nga gjyqtari i seancës paraprake me kërkesë të prokurorit. të viktimës ose trashëgimtarëve të saj”. Dispozita procedurale e mësipërme nuk parashikon vetëm situatën kur dalin apo zbulohen “prova të reja”, por edhe situatën kur dalin apo zbulohen “të dhëna të reja”. Të dhënat e reja nuk janë prova dhe nuk kanë të njëjtin kuptim si dhe provat, pasi me këtë shprehje përfshihen edhe rrethana të reja, të ndryshme nga provat, të cilat në momentin që zbulohen apo konstatohen mund të vënë në diskutim bazueshmërinë në ligj të vendimit për pushimin e çështjes penale. Në rastin e vendimit për pushimin e çështjes penale ndaj shtetasit Fatmir Mediu, pas vendimit të pushimit të çështjes me nr.6, datë 14.09.2009, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, kanë ndodhur ndryshime të statusit juridik të deputetit, ndryshime kushtetuese dhe ligjore të shtrirjes së imunitetit parlamentar ndaj procesit penal, rrethana të cilat arrijnë të përbëjnë të dhëna të reja në kuptim të nenit 329/c të K.Pr.Penale. ... Heqja e pengesës së “autorizimit për proçedim” si kusht paraprak për të proceduar me ushtrimin e ndjekjes penale ndaj deputetit, që ka qënë e parashikuar në nenin 73, paragrafi (2) i Kushtetutës në kohën e marrjes së vendimit nr. 6, datë 14.09.2009, nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është një rrethanë e re që nuk ka ekzistuar në kohën e marrjes së vendimit penal të mësipërm. Mungesa e autorizimit për procedim, ku është bazuar vendimi i pushimit i dhënë nga Gjykata e Lartë, edhe sipas ligjit të kohës ka qënë kusht pengues i përkohshëm, pasi nëse jepej autorizimi apo nëse zhdukej kushti personal për të cilin jepej autorizimi, ndjekja penale mundej të vazhdonte. Kështu, që në kuptim të ligjit procedural penal, kërkesa për revokimin e vendimit të pushimit, nuk sjell asnjë situatë të re, të paparashikuar nga dhe që buron nga një ligj i mëvonshëm, për vendimin e pushimit të çështjes penale. Në ligjin e kohës, në nenin 292 të K.Pr.Penale, parashikohet mundësia e rifillimit të ndjekjes penale. Në ligjin aktual, në nenin 329/c të K.Pr.Penale, parashikohet mundësia e revokimit të vendimit të pushimit”.

21. Në datën 19.07.2021 shtetasi Fatmir Mediu (*me anen e mbrojtësit të tij të zgjedhur me prokurë të përgjithshme*) dorëzoi në sekretarinë e gjykatës një memo bashkëlidhur saj dhe dokumentacion shoqërues me anë të së cilës ndër të tjera pretendon se :

- Kërkesa e organit të akuzës për revokimin e vendimit të pushimit të çështjes penale, nënshkruar në datën 05.05.2021 nga prokurori Braho përbën një akt absolutisht të pavlefshëm. Neni 128/a, parag. 1, gërma (b), i K.Pr.Penale çmon si të tilla të gjitha aktet kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me të drejtën e prokurorit për ushtrimin e pjesëmarrjes së tij në procedim. Prokuroria e Posaçme nuk ka regjistruar ende një çështje të re kundër shtetasit Fatmir Mediu nga shorti i të cilës mbi procedurash ligjore shortimi të jetë caktuar prokurori Braho. Nuk ka asnjë akt, shqyrtim dhe vendim të përfitimit të kompetencës nga Prokuroria e Posaçme apo prokurori Braho për ta legjitimuar atë si prokuror të çështjes.
- Mbi viktimën apo trashëgimtarët përkatës ju informojmë se kërkesa revokuese, krahas kundështimeve mosfilluese është tashmë një veprim i përsëritur disa herë e me dështim absolut si të përmbajtur në përgjigjet e hallkave të ndryshme të prokurorisë po ashtu edhe nga gjykatat që janë ankuar duke e kthyer çështjen revokuese në gjë të gjykuar (referohet në vendimin nr. 3281 regj. them. dt. 16.07.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimin nr. 317 akti dt. 30.04.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë¹² i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. 950 dt. 08.07.2019).
- Kërkesa e organit të akuzës nuk gjen mbështetje në asnjë dispozitë procedurale penale. Vendimi nr. 6, dt. 14.09.2009 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është një vendim themeli. Ky vendim nuk është vendim i gjyqtarit të seancës paraprake i cili në atë kohë nuk ishte parashikuar në ligj si figurë procedurale penale. Në çdo rast gjyqtari i seancës paraprake mbetet një subjekt i hetimeve paraprake të një çështjeje dhe jo i gjykimit si titull i mëpasshëm procedural. Vendimi nr. 6, dt. 14.09.2009 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është një vendim themeli i cili mund të çenohet vetëm përmes institutit të rishikimit referuar nenit 449 - 450 të K.Pr.Penale në fuqi në kohën e dhënies së tij.
- Neni 329/c i K.Pr.Penale përcakton rregulla procedurale për rastin e revokimit të vendimit të pushimit të dhënë nga gjyqtari i seancës paraprake dhe të dhënë për një vendim që lidhet me përfundimin e hetimeve paraprake. Neni 329/c i K.Pr.Penale nuk lidhet me një vendim të marrë pas shqyrtimit në themel të një çështjeje.
- Neni 7 i K.Pr.Penale ndalon gjykimin dy herë për të njëjtin fakt. Rezulton se shtetasit Feruzan Durdaj dhe Zamira Durdaj kanë paraqitur para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesën me objekt: “*Revokimin e vendimit të pushimit të ndjekjes penale të shtetasit Fatmir Mediu (vendimit nr. 6 dt. 14.09.2009 të Gjykatës së Lartë)*”, kërkesë

¹² Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 317 akti dt. 30.04.2019 ka vendosur: “*Mospranimin e kërkesës së kërkuarve Feruzan Durdaj dhe Zamira Durdaj me objekt – “Revokimin e vendimit të pushimit të ndjekjes penale të shtetasit Fatmir Mediu (vendimit nr. 6 dt. 14.09.2009 të Gjykatës së Lartë)”*”.

për të cilën Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 317 akti dt. 30.04.2019 ka vendosur mospranimin e kërkesës vendim i cili lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. 950 dt. 08.07.2019 të saj. Prokuroia e Posaçme nuk ka tagër që të bëjë një vlerësim të ndryshëm nga ai që ka bërë gjykata lidhur me kërkesën e këtyre shtetasve.

- Në rastin konkret pas vendimit të dhënë nga Gjykata e Lartë nuk ka dalë asnjë provë. e tillë nuk mund të konsiderohet kërkesa e shtetasve Feruzan Durdaj dhe Zamira Durdaj dhe as mungesa e imunitetit të shtetasit fatmir Mediu pasi nuk janë të dhëna apo prova të reja të cilat tregojnë se vendimi nuk është i bazuar dhe nuk kanë lidhje dhe as nuk shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë të pandehurit. Togfjalëshi “dalin ose zbulohen të dhëna apo prova të reja” i parashikuar nga neni 329/c i K.Pr.Penale duhet të interpretohet referuar vendimit unifikues nr. 6 dt. 11.10.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë¹³.
- Ndjekja penale në rastin konkret është parashkruar dhe çdo sukses revokues sado absurd është nuk shoqërohet me dritë jeshile proceduese për më tej. Në rastin konkret rezulton se fakti penal i pretenduar ka ndodhur para datës 15.03.2008 dhe shtetasi Fatmir Mediu është akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 248 – 25 të K.Penal dhe nenet 70/2 e 2 të Kodit Penal Ushtarak në lidhje me nenin 25 të K.Penal. Referuar nenit 66 të K.Penal¹⁴ dhe masës së dënimit që parashikojnë dispozitat ligjore për të cilat akuzohet ndjekja penale është parashkruar pasi që në datën 13.03.2009 për mbi 12 vjet shtetasi Fatmir Mediu nuk e ka më cilësinë e të pandehurit.

22. Në datën 21.07.2021 shtetasit Feruzan Durdaj dhe Zamira Durdaj (në cilësinë e trashëgimtarëve të viktimës E.D i cili ka humbur jetën në moshën 7 vjeçare në ngjarjen e dt. 15.03.2008 në Gërdec) dorëzuan në sekretarinë e gjykatës shkresën me lëndë “parashtrime të viktimize të krimit” me anë të së cilës ndër të tjera pretendojnë se :

- Bazuar në nenin 58, pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, viktima e një krimi ka të drejtë të kërkojë procedimin e fajtorit. Një nga personat e pandehur që nuk është

¹³ Vendimit Unifikues nr. 6 dt. 11.10.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ndër të tjera përcakton : “... *prova* qe sherben si shkak per rishikim duhet te jete e re, ne kuptimin qe ajo te kete dale ose te jete zbuluar pasi vendimi te kete marre forme te prere. Ne lidhje me kete ligjvonesi ka perdorur shprehjet : “... kane dale” ose “jane zbuluar”. Kuptimi i ketyre dy shprehjeve, nga pikepamja e qellimit te perdorimit te tyre, ne permbajtjen e shkronjes “c” te nenit 450 te K.Pr.Penale, eshte i njejte. Ne te dy rastet behet fjale per prova, te cilat, megjithese kane ekzistuar objektivist ne kohen kur u shqyrtua ceshtja, ato nuk ishin paraqitur nga palet deri ne momentin qe vendimi ka marre forme te prere, pasi ekzistenca e tyre nuk dihej, deri ate here, prej tyre (paleve). ... Dallimi midis shprehjeve “... kane dale...” dhe “... jane zbuluar”, konsiston ne faktin se shprehja e pare perdoret ne rastin kur ekzistenca e provave te reja qe kane lidhje me nje vendim penal te formes se prere te meparshem evidentohet gjate nje procesi hetimor ose gjyqesor tjetër, i cili nuk ka lidhje me ceshtjen per te cilen eshte dhene vendimi qe kerkohet te rishikohet dhe jane fiksuar ne aktet procedurale (proces-verbalet) e dosjes perkatese. Kurse e dyta, kur palet e interesuara, per te verifikuar pretendimet ose dyshimet e tyre ne lidhje me vertetesine dhe drejtesine e vendimit te dhene, kryejne veprimtari verifikuese, mbasi ky vendim ka marre formen e prere.

¹⁴ Neni 66 shkronja “b” i K.Penal me titull “Parashkrimi i ndjekjes penale” përcakton : “Nuk mund të bëhen ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit sit ë pandehur kanë kaluar : ... b) dhjetë vjet për krimet që parashikojnë dënim nga pesë gjer në dhjetë vjet burgim. ...”.

gjykuar asnjëherë për ngjarjen e Gërdecit, është shtetasi Fatmir Mediu, me detyrë ish Ministër i Mbrojtjes në kohën e ngjarjes. Dispozita në fjalë i jep të drejtën viktimës dhe trashëgimtarëve të tij, që të kërkojnë nga organet përkatëse, që të kryejnë të gjitha veprimet e duhura për të dërguar përpara drejtësisë personat ndaj të cilëve ka prova të mjaftueshme për të kërkuar dënimin e tyre. Konkluzioni që shtetasi Fatmir Mediu duhet dërguar në gjykatë është i vetë Prokurorisë së Përgjithshme, megjithëse pas pushimit të kërkesës në vitin 2009 nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të rifilluar çështjen, pas rënies së shkaqeve penguese.

- Siç shprehet edhe Gjykata e Lartë në vendimin nr. 9 datë 13.06.2011, prokurori nuk ka asnjë pengesë ligjore për ushtrimin e ndjekjes penale për të njëjtin fakt dhe të njëjtin person nëse i jepet auzozimi nga organi kompetent, ose në momentin që zhduket kushti personal që e bën të domosdoshëm autorizimin (bie imuniteti për shkak të mos qenit më deputet). Në rastin konkret, ndryshimet kushtetuese të vitit 2012 e kanë zhdukur kushtin për të kërkuar autorizimin.
- Gjithashtu, në këtë kërkesë nuk janë të pranishme pengesat e tjera që konstatoi Gjykata e Lartë e cila rrëzoi kërkesën, sepse : së pari, nuk jemi para rastit që kërkues është një shoqatë, por janë trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit E.D, së dyti, nuk jemi para rastit që ligji nuk i njeh të drejtë viktimave, pasi me ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale në vitin 2017 (me ligjin nr. 35/2017), viktimat kanë të drejta të zgjeruara, të njohura për herë të parë nga legjislacioni procedural penal. Madje tashmë viktimat njihet si palë në procesin penal dhe dëgjohet nga gjykata. Ky arsyetim bazohet edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila në çështjen Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë, u shpreh se ky set të drejtash i njihet viktimës dhe të afërmeve të tij, që ata të bëhen pjesë aktive e procesit penal.
- Deri më sot nuk ka gjetur zgjidhje çështja më sipër, por me ndryshimin e legjislacionit përkatës, besojmë se jemi në kushtet e duhura që kjo kërkesë të marrë përgjigje pozitive dhe çështja në fjalë të dërgohet në gjykatë. Një rrethanë që e vë në diskutim bazueshmërinë e vendimit të pushimit dhe e bën të revokueshëm është edhe ndryshimi i ligjit që nuk kërkon më asnjë autorizim për të vijuar me ndjekjen penale që ka nisur. Amendamenti kushtetues i vitit 2012 e ka hequr kërkesën për autorizim për procedimin e deputetëve. Heqja e pengesës për të proceduar më tej me ndjekjen penale, është një rrethanë e re, e cila nuk ka ekzistuar në momentin e marrjes së vendimit nr. 6 datë 14.09.2009 nga Gjykata e Lartë (vendimi objekt i kërkesës).
- Mungesa e autorizimit në kohën e nxjerrjes së vendimit nr. 6 datë 14.09.2009 nga Gjykata e Lartë, ka qenë një kusht pengues i përkohshëm, i cili vetë sipas ligjeve të kohës, nëse autorizimi jepej, ose kushti personal zhdukej, ndjekja penale vijonte. Kërkesa për revokimin e vendimit nuk sjell asnjë situatë të re, të papritur, që buron nga një ligj i mëvonshëm, për subjektin e atij vendimi, dhe për rrjedhojë nuk cenon parimin e sigurisë juridike.

- Ndryshimet ligjore në K.Pr.Penale me anë të ligjit nr. 35/2017, kanë hequr edhe kërkesën e autorizimit për ndjekjen penale nga gërma “c” e nenit 290. Kjo për arsye sepse këto ndryshime kanë reflektuar situatën e re juridike për shkak të amendamentit kushtetues të vitit 2012. Në këtë kuptim, ligjvënësi ka hequr si rudiment të panevojshëm edhe parashikim për rifillimin e ndjekjes penale kur autorizimi jepet (i cili nuk jepet më që prej vitit 2012), duke e konsideruar si një instrument obsolet. Por, të njëjtat ndryshime bëjnë që vendimi nr. 6, datë 14.09.2009 i Gjykatës së Lartë të jetë i pabazuar. Rikujtojmë se pengesa në këtë rast ishte e përkohshme dhe më pas inekzistente. Ndjekja penale në këtë rast nuk ka asnjë pengesë ligjore të vazhdojë dhe e vetmja pengesë është vendimi objekt i kërkesës, i cili pengon organin e akuzës të vijojë më tej me ndjekjen penale.
- Nëse GJKKO, pavarësisht nga argumentimi në lidhje me zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të nenit 2 të KEDNJ më sipër, ka paqartësi për zbatimin e nenit 292 të Kodit të Procedurës Penale, i cili me pamjen e sotme “të cunguar” mund të krijojë vakum për rifillimin e ndjekjeve penale të pushuara për shkak të mosdhënies së autorizimit për procedim, duke rënë ndesh me detyrimet pozitive që burojnë nga neni 2 i KEDNJ, gjykata duhet të mos e zbatojë atë, duke vendosur pezullimin e shqyrtimit të mëtejshëm të çështjes dhe dërgimin e kërkesës për kontroll incidental në Gjykatën Kushtetuese, për t’u shprehur për kushtetutshmërinë e nenit 292 të K.Pr.Penale. Në rastin eventual të shfuqizimit të kësaj dispozite, si të papajtueshme me nenin 2 të KEDNJ, gjykata nuk do të kishte asnjë pengesë teorike apo praktike për të pranuar të plotë kërkesën e SPAK.

II. Ligji i zbatueshëm.

23. Neni 292 i K.Pr.Penale me titull “*Rifillimi i hetimeve*” parashikon se: “*Vendimi i mosfillimit të procedimit ose i pushimit, të dhënë për shkak të mungesës së ankimit, nuk pengojnë kryerjen e hetimeve për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtit person, në qoftë se më pas bëhet ankim*”.

24. Neni 329/c i K.Pr.Penale me titull “*Revokimi i vendimit të pushimit*” parashikon se: “*1. Kur pas vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes dalin ose zbulohen të dhëna apo prova të reja, të cilat tregojnë se vendimi nuk është i bazuar, ai mund të revokohet nga gjyqtari i seancës paraprake me kërkesë të prokurorit, të viktimës ose trashëgimtarëve të saj. Kërkesa, së bashku me aktet dhe provat e reja, depozitohet në sekretarinë e gjykatës.*

2. Kërkesa shoqërohet me provat e reja me pasojë mospranimi.

3. Kërkesa shqyrtohet në dhomë këshillimi. Kur vendos pranimin e kërkesës, gjykata revokon vendimin e pushimit dhe i kthen aktet prokurorit, i cili rifillon hetimet.

4. Në përfundim të hetimeve, kur nuk procedon sipas neneve 328, 329/a, 406/a ose 406/dh, të këtij Kodi, prokurori paraqet në gjykatë kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq”.

25. Neni 329/ç i K.Pr.Penale i cili parashikon se: *“Kundër vendimit të mospranimit ose të rrëzimit të kërkesës për revokimin e vendimit të pushimit, prokurori, viktima ose trashëgimtarët e saj, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e apelit, e cila shqyrton ankimin në dhomë këshillimi”*.

III. Analiza ligjore dhe vlerësimi i gjykatës.

26. Në datën 29.06.2021 Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka regjistruar për gjykim çështjen penale me Nr. 60 Regj. Them. Kjo çështje penale ka ardhur për gjykim pranë kësaj gjykate nga Gjykata e Lartë e cila me vendimin nr. 1, dt. 01.06.2021 ka vendosur: *“1. Deklarimin e moskompetencës lëndore për shqyrtimin e kërkesës penale nr. 000-0001-2021 dt. 05.05.2021. 2. Dërgimin e akteve Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”*.

27. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka paraqitur kërkesën për revokimin e vendimit të pushimit të çështjes penale në ngarkim të shtetasit Fatmir Mediu, e pushuar me vendimin nr. 6, dt. 14.09.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë duke parashtruar se: *“...Në rastin e vendimit për pushimin e çështjes penale ndaj shtetasit Fatmir Mediu, pas vendimit të pushimit të çështjes me nr.6, datë 14.09.2009, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, kanë ndodhur ndryshime të statusit juridik të deputetit, ndryshime kushtetuese dhe ligjore të shtrirjes së imunitetit parlamentar ndaj procesit penal, rrethana të cilat arrijnë të përbëjnë të dhëna të reja në kuptim të nenit 329/c të K.Pr.Penale. ... Heqja e pengesës së “autorizimit për procedim” si kusht paraprak për të proceduar me ushtrimin e ndjekjes penale ndaj deputetit, që ka qënë e parashikuar në nenin 73, paragrafi (2) i Kushtetutës në kohën e marrjes së vendimit nr. 6, datë 14.09.2009, nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është një rrethanë e re që nuk ka ekzistuar në kohën e marrjes së vendimit penal të mësipërm. Mungesa e autorizimit për procedim, ku është bazuar vendimi i pushimit i dhënë nga Gjykata e Lartë, edhe sipas ligjit të kohës ka qënë kusht pengues i përkohshëm, pasi nëse jepej autorizimi apo nëse zhdukej kushti personal për të cilin jepej autorizimi, ndjekja penale mundej të vazhdonte. Kështu, që në kuptim të ligjit procedural penal, kërkesa për revokimin e vendimit të pushimit, nuk sjell asnjë situatë të re, të paparashikuar nga dhe që buron nga një ligj i mëvonshëm, për vendimin e pushimit të çështjes penale. Në ligjin e kohës, në nenin 292 të K.Pr.Penale, parashikohej mundësia e rifillimit të ndjekjes penale. Në ligjin aktual, në nenin 329/c të K.Pr.Penale, parashikohet mundësia e revokimit të vendimit të pushimit”*.

28. Në lidhje me çështjen objekt gjykimi, Gjykata konstaton se neni 292 i K.Pr.Penale që ka qënë në fuqi në kohën e marrjes së vendimit nr. 1, dt. 01.06.2021 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (me titull *“rifillimi i ndjekjes penale”*) i cili e parashikonte mundësinë e rifillimit të ndjekjes penale kur më pas jepej autorizimi për procedim ose zhdukej kushti personal që e bënte të domosdoshëm autorizimin, është ndryshuar me ligjin nr. 35/2017. Sipas këtyre ndryshimeve ligjore tashmë neni 292 i K.Pr.Penale ka këtë përmbajtje: *“Vendimi i*

mosfillimit të procedimit ose i pushimit, të dhënë për shkak të mungesës së ankimit, nuk pengojnë kryerjen e hetimeve për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtit person, në qoftë se më pas bëhet ankim”. Pra, kjo dispozitë ligjore aktualisht e ka hequr parashikimin për rifillimin e ndjekjes penale kur autorizimi jepet ose zhduket kushti personal që e bënte të domosdoshëm autorizimin. Gjithashtu, Gjykata evidenton se nga përmbajtja e ligjit nr. 35/2017 nuk është përcaktuar ndonjë dispozitë kalimtare që të përcaktojë mënyrën se si do të rregullohen rastet e tjera të ngjashme me çështjen objekt gjykimi. Në këto kushte neni 292 i K.Pr.Penale para ndryshimeve nuk mund të gjejë zbatim pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2017.

29. Në këtë përfundim arrin Gjykata duke mbajtur në konsideratë edhe vendimin nr. 9, datë 01.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese, ku arsyetohet se: “Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj nr.106, datë 27.05.2002 për kushtetutshmërinë e një procesi civil është shprehur, se në të drejtën procedurale, ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe, pra kur vetë ligji ka parashikuar dispozita procedurale transitore. Të njëjtin qëndrim Gjykata Kushtetuese ka mbajtur dhe në çështjet që lidhen me gjykimet penale në gjykatat e sistemit gjyqësor, pasi të drejtat dhe garancitë kushtetuese për një proces të rregullt ligjor i janë njohur dhe dhënë procesit në vetvete, pa e dalluar atë në proces penal apo civil. “Është parim i njohur e i pranuar, se ndryshe nga e drejta penale materiale, ku zbatohet parimi se ligji i ri nuk ka fuqi prapavepruese, me përjashtim të rasteve kur ai është në favor të të pandehurit, në të drejtën procedurale penale vepron parimi sipas të cilit, ligji i ri ka fuqi edhe ndaj marrëdhënieve procedurale të lindura para hyrjes së tij në fuqi, për çështje që gjenden në hetim apo gjykim, me përjashtim të rasteve e për një kohë kur vetë ligji shprehimisht ka vendosur”.

30. Me ligjin nr. 35/2017 në K.Pr.Penale janë bërë edhe një sërë ndryshimesh ligjore të tjera. Një nga këto ndryshime është edhe krijimi i një figure të re gjyqtari, gjyqtari i seancës paraprake i cili sipas parashikimeve të K.Pr.Penale (neni 13 i tij) shqyrton edhe kërkesat e prokurorit për pushimin e akuzës ose çështjes (nenet 328 – 332/gj të K.Pr.Penale). Në kompetencën e gjyqtarit të seancës paraprake është edhe shqyrtimi i kërkesës për revokimin e vendimit të pushimit sipas përcaktimit të nenit 329/c të K.Pr.Penale (dispozitë ligjore e shtuar me ligjin nr. 35/2021).

31. Duke mbajtur parasysh situatën ligjore sa më sipër, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm për gjykimin e çështjes objekt gjykimi, Gjykata ndan të njëjtin qëndrim me Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë i cili ka vlerësuar se : “25. ... Gjithashtu, Kolegji vlerëson se ligji i zbatueshëm në lidhje me kërkesën objekt gjykimi është Kodi i Procedurës Penale i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017 dhe me ligjin nr. 41/2021, datë 23.3.2021. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji nuk është parashikuar ndonjë dispozitë kalimtare, e cila të rregullonte ligjin procedural të zbatueshëm për çështjet penale që kishin nisur para hyrjes në fuqi të ndryshimeve. Parimi i përgjithshëm i të drejtës procedurale tempus regit actum përcakton se ligji i zbatueshëm është ligji që është në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes penale. Për këto arsye, kërkesa për revokimin e vendimit të pushimit të çështjes penale do

të rregullohet nga ligji procedural që është në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës, që është neni 329/c i Kodit të Procedurës Penale, të ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017 ...”.

32. Ndodhur në këto kushte, Gjykata çmon të trajtojë paraprakisht insitutin e revokimit të vendimit të pushimit, për të konkluduar më pas nëse kërkesa e prokurorisë është e bazuar në prova dhe në ligj.

1. Lidhur me revokimin e vendimit të pushimit.

33. Gjykata Kushtetuese, në disa vendime të saj ka pranuar, se siguria juridike është ndër elementët thelbësorë të shtetit të së drejtës dhe kjo siguri presupozon, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Në harmoni me parimin e sigurisë juridike, ligji procedural ka sanksionuar edhe parimin e gjësë së gjykuar (*res judicata*).¹⁵ Në aspektin formal e procedural, *gjë e gjykuar* nënkupton përfundimin, në drejtim të mosankueshmërisë së vendimit gjyqësor, ndërsa, në atë substancial, nënkupton fuqinë e detyrueshme të vendimit të gjykatës. Ky parim është i zbatueshëm, jo vetëm ndaj palëve në gjykim, por edhe ndaj të gjitha autoriteteve publike brenda juridiksionit që janë të interesuara ose të përfshira në përmbajtjen e vendimit të gjykatës.¹⁶ Tipar karakteristik i gjësë së gjykuar është se kur në vendimin e parë çështja e ngritur është konsideruar e pabazuar në themel, ajo nuk mund të shqyrtohet më tej. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kufijtë e zbatimit të parimit të gjësë së gjykuar përcaktohen në lidhje të ngushtë me thelbin e mosmarrëveshjes në gjykim. Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese çmon se gjëja e gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por dhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkuese arsyetuese të vendimit me kusht, që të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe t’i përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj.¹⁷ Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike. Ndërsa, në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Pra kur vendimi ka marrë formë të prerë ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera.¹⁸

34. Në analizimin e kuptimit të shprehjes “formë e prerë”, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë¹⁹ kanë arsyetuar se, përjasja më e drejtë do të ishte ajo që lidhet me efektet

¹⁵ Shiko vendimin Nr. 9, datë 26.02.2007 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁶ Shiko vendimin Nr. 29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁷ Shiko vendimin Nr. 24, datë 12.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁸ Shiko vendimin Nr. 2, datë 16.01.2013 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁹ Shiko vendimin Unifikues Nr. 2, datë 03.11.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

e “formës së prerë”, të cilat kanë të bëjnë me shterimin e mjeteve të zakonshme të ankimit ose kalimin e afateve për ushtrimin e tyre. Ky është edhe përkufizimi i zgjedhur jo vetëm në shumë legjislacione të ngjashme me atë Shqiptar,²⁰ por edhe në marrëveshje ndërkombëtare në të cilat shteti Shqiptar është Palë. Kështu, në dhënien e një përkufizimi të “vendimit final” Raporti Shpjegues i Konventës Evropiane për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Vendimeve Penale (Raporti Shpjegues)²¹ parashikon në lidhje me nenin 1 se: *Vendimi duhet të jetë final. Një vendim është final, nëse, sipas shprehjes tradicionale, ajo ka fituar fuqinë e res judicata. Ky është rasti kur vendimi është i përvokueshëm, që do të thotë kur nuk ka mjete të mëtejshme të zakonshme në dispozicion ose kur palët i kanë konsumuar këto të tilla ose kanë lejuar që afati të mbarojë pa ushtruar ankim. [...].*

35. Në lidhje me këtë çështje GJEDNJ-ja në disa çështje^{22,23} është shprehur se: *“Gjykata vlerëson se kërkesat e sigurisë ligjore nuk janë absolute. Largimi nga parimi justifikohet vetëm nëse një gjë e tillë bëhet e nevojshme nga rrethanat dhe nga karakteri substancial detyrues, ose kur ka arsye serioze legjitime që janë më me peshë se siguria juridike”. Kështu, në çështjen “Xherak kundër Shqipërisë” GJEDNJ-ja²⁴ ndër të tjera është shprehur se: “1. Gjykata vë re se qëllimi i nenit 4 të protokollit nr.7 është që të parandalojë përsëritjen e proceseve penale që kanë përfunduar me vendim përfundimtar. Gjykata thekson se qëllimi i raportit shpjegues të protokollit nr.7 është të ndalohet përsëritja e procesit penal për të cilin ka përfunduar një vendim përfundimtar. Sipas raportit shpjegues të protokollit nr.7, i cili në vetvete i referohet Konventës evropiane për vlefshmërinë ndërkombëtare të vendimeve penale, “një vendim është përfundimtar ‘nëse, sipas shprehjes tradicionale, ai ka marrë fuqi res judicata. Ky është rasti kur vendimi është i pakthyeshëm, pra kur nuk ka mjete të tjera të disponueshme ose kur palët i kanë shfrytëzuar këto mjete ose kanë lejuar skadimin e afatit kohor pa i përdorur ato’ ” (shih Nikitin, cituar më lart, § 37). 2. Gjykata konstaton se vendimi i pafajësisë i datës 14 dhjetor 1998 u bë përfundimtar më 24 dhjetor 1998, pasi kundër tij nuk u bë asnjë apel brenda afatit prej dhjetë ditësh të parashikuar në ligj (shih paragrafët 16 dhe 38 më lart). Në këtë mënyrë, mbetet të përcaktohet nëse proceset që u zhvilluan pas dhënies së lejes për rivendosje në afat konsiderohen si gjykim i dytë ose si*

²⁰ Shtete të cilat e lidhin formën e prerë me shterimin e mjeteve të ankimit të zakonshëm janë: Italia (neni 648 i K.Pr.Penale); Greqia (neni 546 i K.Pr.Penale); Zvicra (neni 437 i K.Pr.Penale); Kosova (neni 485 i K.Pr.Penale); Maqedonia (neni 125 i K.Pr.Penale); Bullgaria (neni 412 i K.Pr.Penale); Bosnja (neni 178 i K.Pr.Penale); Mali i Zi (neni 220 i K.Pr.Penale); Serbia (neni 275 i K.Pr.Penale) Sllovenia (neni 129 i K.Pr.Penale); Estonia (neni 408 i K.Pr.Penale); etj.

²¹ Raport Shpjegues i Konventës Evropiane për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjytimeve Penale, CETS No. 70, bërë në Hagë me datë 28.05.1970, ratifikuar me Ligjin nr.9068, datë 15.05.2003, “Për ratifikimin e “Konventës Evropiane për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjytimeve Penale”. Cituar gjithashtu nga Raporti Shpjegues i Protokollit nr.7 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996 “Për Ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”.

²² Çështja “Ryabykh kundër Rusisë” nr. 52854/99, fq.52, ECHR 2003-IX).

²³ Çështja “Bratyakin kundër Rusisë” nr. 53203/99, fq.63-68, 15 Dhjetor 2005,

²⁴ Çështja “Xheraj kundër Shqipërisë” nr. 37959/02, 29 Korrik 2008.

rihapje e proceseve të pafajësisë. 3. Sipas mendimit të gjykatës, neni 4 i protokollit nr.7 e bën të qartë dallimin ndërmjet një ndjekjeje ose gjykimi të dytë, i cili ndalohet nga paragrafi i parë i të njëjtit nen, dhe rihapjes së gjykimin në raste përjashtimore, gjë që parashikohet në paragrafin e dytë. Neni 4 § 2 i protokollit nr.7 parashikon shprehimisht mundësinë që një individ duhet ta pranojë ndjekjen për të njëjtat akuza, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, kur një çështje rihapet pas daljes së një prove të re ose pas zbulimit të një defekti thelbësor në proceset e mëparshme (shih Nikitin, cituar më lart, § 45).”.

36. Mbështetur në jurisprudencën e GJEDNJ-së, Gjykata çmon se insituti i revokimit të vendimit të pushimit të akuzës osë të çështjes parashikuar nga neni 329/c të K.Pr.Penale, shtuar me Ligjin Nr. 35/2017, është në përputhje me pikën 2 të nenit 4 të Protokollit nr.7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.²⁵ Kërkesa për revokim pavarësisht se nuk parashikohet në kapitullin e VIII-të “Ankimet”, Kreun IV, mendojmë se është identike me “Rishikimin” si mjet i jashtëzakonshëm për të goditur një vendim përfundimtar. Kjo për këto arsye: **së pari**, si rishikimi ashtu dhe kërkesa për revokim të vendimit të pushimit janë mjete të jashtëzakonshme për të goditur një vendim, të cilit i kanë shteruar të gjitha mjetet e ankimit. **Së dyti**, objekti i shqyrtimit të kërkesës për rishikim dhe revokim është nëse vendimi i formës së prerë ka rezultuar i “padrejtë” për shkaqe të jashtme, të panjohura për gjykatën në momentin e vendimmarrjes. Pra, karakteristikë e përbashkët e të gjitha shkaqeve të rishikimit dhe revokimit, është fakti se vendimi penal, për të cilin kërkohet rishikimi dhe revokimi është i gabuar jo për pakujdesi të gjykatës, pra për mosrespektim të së drejtës për një proces të parregullt të bërë prej saj, por për shkaqe të pavarura prej saj e që nuk dihen në momentin e marrjes së vendimit. **Së treti**, qëllimi i kërkesës për rishikim dhe revokim, është pikërisht *rihapja* e një procesi gjyqësor apo hetimor të mbyllur tashmë. **Së katërti**, “karakterit i jashtëzakonshëm” i rishikimit si mjet ankimi dhe kërkesës për revokim të vendimit të pushimit del edhe nga fakti se ligjvënësi nuk i ka kufizuar brenda një afati kohor ndërkohë që mjetet e zakonshme të ankimit duhet të paraqiten brenda afateve strikte kohore me pasojë papranueshmërinë e tyre. **Së pesti**, motivet e revokimit të vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes janë identike me motivet e rishikimit të parashikuara nga neni 450 pika 1 gërma “c” të K.Pr.Penale. Ndodhur në këto kushte, arsyet ligjore që përlijin insitutin e rishikimit qëndrojnë edhe për insitutin e revokimit të vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes. Konkretisht nëpërmjet këtyre insituteve vihet në balanc raporti midis **parimit të sigurisë juridike**, që instalohet përmes vendimit të formës së prerë (*res judicata*), për palët e procesit nga njëra anë, dhe **interesit të drejtësisë**, thelbi i të cilit është zbulimi i së vërtetës, nga ana tjetër.

²⁵ Në këtë nen parashikohet shprehimisht se: “1. Asnjë nuk ka të drejtë të gjykohet ose të dënohet dy herë në procese penale sipas juridiksionit të të njëjtit shtet për një vepër penale për të cilën ai është deklaruar përfundimisht i pafajshëm ose është dënuar në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të atij shteti. 2. *Dispozitat e paragrafit më lart nuk parandalojnë rihapjen e çështjes në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të shtetit në fjalë nëse ka prova të fakteve të reja ose të zbuluara rishtazi, ose nëse ka pasur një defekt thelbësor në proceset e mëparshme, i cili mund të ketë pasur ndikim mbi çështjen.* 3. Nga ky nen nuk ka përjashtim sipas nenit 15 të Konventës.”

37. Neni 329/c i K.Pr.Penale²⁶ parashikon mundësinë e revokimit të vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes kur pas vendimit **dalin ose zbulohen të dhëna apo prova të reja**, të cilat tregojnë se vendimi nuk është i bazuar. Vlerësimi i ndryshëm i rrethanave të çështjes apo i objektit të çështjes nuk përbën shkak për rihapje të procesit të mbyllur me një vendim të formës së prerë. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe jurisprudenca e Gj.E.D.Nj-së.²⁷ Kështu në çështjen “Rosca kundër Moldavisë”, nr.6267/02, § 24, 22 Mars 2005, **kjo gjykatë shprehet:** “Kompetencat për rishikim të gjykatave më të larta duhen ushtruar për korrigjimin e gabimeve gjyqësore dhe dështimeve në dhënien e drejtësisë..... Rishikimi nuk duhet trajtuar si një apel i fshehur dhe thjesht mundësia e ekzistencës së dy pikëpamjeve të ndryshme në lidhje me objektin e gjykimit nuk përbën një bazë për rishqyrtim. Anashkalimi i këtij parimi justifikohet vetëm kur kjo bëhet e nevojshme nga rrethanat me natyrë të rëndësishme dhe detyruese”. Pra, nga përmbajta e nenit 329/c të K.Pr.Penale që të mund të jemi përpara revokimit të vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes duhet të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet si më poshtë vijon:

38. **Së pari**, nga kërkuesi, prokurori, viktimi ose trashëgimtarët e saj duhet të paraqiten “**prova**”. Kuptimi i provës penale jepet në nenin 149 të K.Pr.Penale, dispozitë në të cilën përcaktohen edhe elementët përbërës të saj. Nga kuptimi që i jep provës penale, legjislacioni ynë, mund të bëjmë përkufizimin e mëposhtëm; *provë penale konsiderohet çdo njoftim, e dhënë, fakt apo rrethanë, që lidhet me një veprë penale të caktuar, që merret prej burimeve të njohura dhe parashikuara nga ligji procedural, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë tij, si dhe çdo njoftim me interes për zgjidhjen e drejtë të çështjeve*. Provë penale është njoftimi që rrjedh dhe merret nga burimi i provave, burime këto të përkufizuara dhe të njohura si të tilla nga legjislacioni procedural penal. Megjithatë duhet theksuar fakti se me Ligjin Nr. 35/2017 është shtuar neni 8/a i K.Pr.Penale²⁸, ndërsa në nenin 149 të këtij Kodi është shtuar paragrafi i dytë, i cili njeh lirinë e provave dhe marrjen e provave atipike, duke parashikuar se gjykata mund të marrë një provë që nuk rregullohet me ligj në qoftë se ajo vlen për të vërtetuar faktet dhe nuk çënon lirinë e vullnetit të personit, pasi dëgjon palët mbi mënyrën e marrjes së saj. Ky parashikim është shoqëruar me shfuqizimin e paragrafëve 4 dhe 5 të nenit 151. Në kushtet kur kërkesa

²⁶ Në nenin 329/c të K.Pr.Penale me titull “Revokimi i vendimit të pushimit” parashikohet se: “1. Kur pas vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes dalin ose zbulohen të dhëna apo prova të reja, të cilat tregojnë se vendimi nuk është i bazuar, ai mund të revokohet nga gjyqtari i seancës paraprake me kërkesë të prokurorit, të viktimës ose trashëgimtarëve të saj. Kërkesa, së bashku me aktet dhe provat e reja, depozitohet në sekretarinë e gjykatës. 2. Kërkesa shoqërohet me provat e reja me pasojë mospranimi. 3.Kërkesa shqyrtohet në dhomë këshillimi. Kur vendos pranimin e kërkesës, gjykata revokon vendimin e pushimit dhe i kthen aktet prokurorit, i cili rifillon hetimet. 4.Në përfundim të hetimeve, kur nuk procedon sipas neneve 328, 329/a, 406/a ose 406/dh, të këtij Kodi, prokurori paraqet në gjykatë kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq”.

²⁷ Shiko vendimin Nr. 8, datë 22.01.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

²⁸ Në nenin 8/a të K.Pr.Penale nën titullin “**Provat**” parashikohet shprehimisht se: “1. Faktet në procesin penal **provohen me çdo provë**, me kusht që ato të mos cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. 2. Organi procedues duhet të mbledhë dhe të shqyrtojë si provat që fajësojnë të pandehurin, ashtu edhe ato që janë në favor të tij.”.

për revokim të vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes shqyrtohet në dhomë këshillimi duket se është e pamundur që gjykata të administrojë prova atipike, pasi nuk mund të dëgjojë palët mbi mënyrën e marrjes së saj. Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë²⁹ deklaratat noteriale nuk janë konsideruar si prova për rishikim, pasi ajo nuk e zëvendëson dëshminë e dhënë nga dëshmitari e cila në bazë të nenit 157 të K.Pr.Penale merret në mënyrë të drejtpërdrejtë nga gjykata.

39. **Së dyti**, provat e paraqitura duhet të jenë “**prova të reja**”. Sipas Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë,³⁰ provat duhet të jenë të reja, në kuptimin që kanë dalë apo janë zbuluar pas dhënies të vendimit. Duhet të bëhet fjalë “[...] *për prova, të cilat, megjithëse kanë ekzistuar objektivisht në kohën kur u shqyrtua çështja, ato nuk ishin paraqitur nga palët deri në momentin që vendimi ka marrë formë të prerë, pasi ekzistenca e tyre nuk dihej, deri atëherë, prej tyre (palëve)*. Mosdijenja e palëve për ekzistencën e këtyre provave, në këto raste e ka burimin ose në mosthellimin e tyre në procesin e zbulimit ose në pamundësinë dhe pengesat reale që ato mund të kenë hasur gjatë këtij procesi. Vështirësitë dhe pengesat në këto raste mund t’ a kenë burimin sa në mosthellimin dhe mungesat profesionale të personave që janë të ngarkuar me zbulimin dhe administrimin e provave, të një vepre penale, aq edhe në veprimtarinë keqbërëse të personave të interesuar për fshehjen, prishjen dhe manipulimin e tyre. Provat konsiderohen që **kanë dalë** pas dhënies së vendimit kur ato janë evidentuar gjatë një procesi penal tjetër (në proces-verbalet e dosjes përkatëse), i cili është zhvilluar pas dhënies së vendimit që kërkohet të rishikohet dhe që nuk ka lidhje me çështjet për të cilat është dhënë ai vendim. Provat **janë zbuluar** kur palët e interesuara për rishikim, kryejnë veprimtari verifikuese pas dhënies së vendimit që ka marrë formë të prerë.

40. **Së treti**, provat e reja, të cilat janë zbuluar rishtas duhet të jenë të një rëndësie të tillë, që nëse gjykata apo prokuroria³¹ do të ishte në dijeni të tyre, do të kishte dhënë një vendim të ndryshëm me atë që ka dhënë. Po ashtu, prova e re duhet të ketë lidhje me një fakt që nuk është pranuar nga ana e gjykatës apo e prokurorisë në vendimin e pushimit.³²

41. Duke u rikthyer në rastin konkret objekt gjykimi, Gjykata vlerëson se kërkesa e prokurorisë për revokimin e vendimit të pushimit të çështjes penale në ngarkim të shtetasit Fatmir Mediu, (pushuar me vendimin nr. 6, datë 14.09.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë) duhet të rrëzohet si e pa bazuar në ligj. Gjykata arrin në këtë përfundim duke mbajtur në konsideratë argumentat sa më poshtë:

42. Kështu, siç u analizua dhe më lart neni 329/c i K.Pr.Penale parashikon mundësinë e revokimit të vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes vetëm në rastin **kur pas vendimit dalin ose zbulohen të dhëna apo prova të reja, të cilat tregojnë se vendimi nuk është i bazuar**. Vlerësimi i ndryshëm i rrethanave të çështjes apo i objektit të çështjes nuk përbën

²⁹ Shiko vendimet Nr. 123, datë 10.04.2013 dhe Nr. 8, datë 22.01.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

³⁰ Shiko vendimin Unifikues Nr. 06, datë 11.10.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

³¹ Në rastet kur diponon për pushimin e akuzës apo të çështjes për kundërvatje penale që është kompetenc e saj ekskluzive sipas nenit 329 pika 1 të K.Pr.Penale.

³² Shiko vendimin Unifikues Nr. 1, datë 31.01.2006 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

shkak për rihapje të procesit të mbyllur me një vendim të formës së prerë. Në lidhje me këtë çështje, Gjykata çmon që të ndalet duke marrë në analizë se çfarë do të kuptojmë me shprehjen “*të dhëna apo prova të reja*”. Kështu, në lidhje me përcaktimin e kuptimit të provës na vjen në ndihmë neni 149 i K.Pr.Penale me titull “*Kuptimi i provës*”. Sipas kësaj dispozite ligjore legjislacioni ynë e përkufizon provën penale si çdo njoftim, të dhënë, fakt apo rrethanë, që lidhet me një vepër penale të caktuar, që merret prej burimeve të njohura dhe parashikuara nga ligji procedural, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij, si dhe çdo njoftim me interes për zgjidhjen e drejtë të çështjes. Pra, prova penale është njoftimi apo e dhëna që rrjedh dhe merret nga burimi i provave, burime këto të përkufizuara dhe të njohura si të tilla nga legjislacioni procedural penal. Të njëjtin përkufizim në lidhje me provën e jep edhe K.Pr.Civile në nenin 11 të tij kur përcakton: “**Provat janë të dhëna** që merren prej burimeve dhe sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod dhe ligje të tjera, të cilat vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet ose prapësimet e pjesëmarrësve në proces”. Ndërsa në lidhje me kuptimin e fjalës “*të dhëna*” fjalori i gjuhës shqipe na jep këtë përkufizim “*e dhënë – fakte a dokumente që shërbejnë për të vërtetuar a për të provuar diçka*”. **Nga sa më sipër arrijmë në përfundimin se “të dhënat e reja” sipas përcaktimit të nenit 329/c të K.Pr.Penale nuk janë gjë tjetër veçse prova të reja.**

43. Në të njëjtin përfundim si më sipër arrijmë edhe nga interpretimi i paragrafit 2 të nenit 329/c të K.Pr.Penale i cili përcakton se: “2. *Kërkesa shoqërohet me provat e reja me pasojë mospranimi.*”. Pra, edhe vetë ligjvënësi ka përcaktuar qartësisht se kërkesa për revokimin e vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes duhet që të shoqërohet detyrimisht me prova të reja pasi në të kundërt Gjykata vendos mospranimin e saj. Në rast se “të dhënat e reja” dhe “provat e reja” do të kishin kuptime të ndryshme atëherë ligjvënësi nuk do të kishte bërë parashikimin ligjor si më sipër duke e kushtëzuar paraqitjen e kërkesës vetëm me paraqitjen e provave të reja me pasojë mospranimi.

44. Duke mbajtur parasysh përfundimin e arritur si më sipër se qëllimi i insitutit të revokimit të vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes është i njëjtë me insitutin e rishikimit (shiko pikën 33 të pjesës arsyetuese të vendimit), Gjykata vlerëson që në rastin konkret ti referohet dhe të sjellë në vëmendje Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 6, dt. 11.10.2002 i cili ndër të tjera ka unifikuar praktikën gjyqësore në lidhje me shprehjen e perdorur nga ligjvënësi: “*Kur pas vendimit, kane dale, ose jane zbuluar prova te reja...*” (shprehje e njëjtë me shprehjen e parashikuar nga neni 329/c parag. 1 i K.Pr.Penale - si rast për të kërkuar revokimit të vendimit të pushimit). Në vendimin e sipërcituar Gjykata e Lartë ka unifikues theksuar se : “... ***Ne lidhje me kete ligjvënësi ka perdorur shprehjet : “... kane dale” ose “jane zbuluar”. Kuptimi i ketyre dy shprehjeve, nga pikepamja e qellimit te perdorimit te tyre, ne permbajtjen e shkronjes “c” te nenit 450 te K.Pr.Penale, eshte i njejte. Ne te dy rastet behet fjale per prova, te cilat, megjithese kane ekzistuar objektivist ne kohen kur u shqyrtua ceshtja, ato nuk ishin paraqitur nga palet deri ne***

momentin qe vendimi ka marre forme te prere, pasi ekzistenca e tyre nuk dihej, deri atehere, prej tyre (paleve) ... ”.

45. Duke mbajtur parasysh analizën sa më sipër, Gjykata konstaton se nga ana e kërkuetit Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nuk janë paraqitur prova të reja që të tregojnë se vendimi i pushimit të çështjes ndaj shtetasit Fatmir Mediu nuk është i bazuar. Përkundrazi, referuar kërkesës penale objekt gjykimi organi i akuzës parashtron se nuk disponon prova të reja pasi hetimet paraprake ndaj shtetasit Fatmir Mediu janë përfunduar në përputhje me kërkesat e ligjit procedural penal që ka qënë në fuqi në atë kohë ku është marrë edhe vendimi për dërgimin e çështjes në gjyq. Në rastin konkret, rezultoi e provuar që pushimi i çështjes penale ndaj shtetasit Fatmir Mediu është vendosur për shkak të pasjes së imunitetit të deputetit në kohën e dhënies së vendimi. Nga organi i akuzës nuk u sollën prova që të provonin të kundërtën se në kohën e marrjes së vendimit të pushimit të çështjes nga Gjykata e Lartë, shtetasi Fatmir Mediu nuk e kishte statusin e deputetit apo që kishte statusin e deputetit dhe nga ana e Kuvendit ishte dhënë autorizimi për procedim penal sipas kuadrit ligjor që ishte në fuqi në momentin që Gjykata e Lartë morri vendimin e pushimit ndaj tij. Nëse do të silllej një provë e tillë, ky do të ishte një fakt që ka ekzistuar objektivisht se shtetasi Fatmir Mediu nuk ka pasur statusin e deputetit, por nuk është paraqitur nga palët deri në momentin që vendimi ka marrë formë të prerë. Kjo pasi siç përcakton dhe Gjykata e Lartë provat e reja që duhet të paraqiten duhet që të kenë ekzistuar objektivisht në kohën e shqyrtimit të çështjes megjithëse ato nuk janë paraqitur nga palët deri në momentin që vendimi ka marre forme te prere, pasi ekzistenca e tyre nuk dihej, deri atëhere, prej tyre.

2. Raporti midis ligjit të ri dhe një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

46. Organi i akuzës e motivon kërkesën për revokimin e vendimit të pushimit me arsyetimin se me ndryshimet që iu bënë kushtetutës me ligjin nr. 88/2012 deputeti i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nuk gëzon më imunitet parlamentar për ndjekjen penale apo gjykimin e tij duke rënë kështu kushti pengues për vazhdimin e gjyqimit.

47. Ndodhur në këto kushte, Gjykata në rastin konkret çmon të trajtoj nëse ndryshimi i një dispozite ligjore mund të afektojë me fuqi prapavepruese zgjidhjen e dhënë me një vendim penal të formës së prerë sikurse është dhe vendimi i pushimit të çështjes penale me motivin se ndjekja penale nuk mund të vazhdojë. Për t'i dhënë zgjidhje kësaj çështje, Gjykata çmon t'i referohet jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese. Kështu, në vendimin Nr. 6 datë - 17.02.2012 Gjykata Kushtetuese ndër të tjera ka theksuar se: “15. Gjykata vëren se parimi i përgjithshëm është se ligjet i shtrijnë efektet për marrëdhëniet juridike që lindin pas hyrjes së tyre në fuqi. Teoria e së drejtës pranon se fuqia prapavepruese zbatohet si përjashtim, për shembull, në ligjet penale favorizuese, në ligjet që ndërhyjnë për të rregulluar situata të paligjshme të krijuara më parë, në ligjet që interpretojnë anët e errëta ose të paqarta të një ligji të mëparshëm dhe në ndonjë rast tjetër ku paraqitet domosdoshmëria për të shmangur pasoja të rënda, negative ose të pandreqshme (shih vendimin nr.9, datë 26.02.2007 të Gjykatës Kushtetuese). **Kuvendi nuk ndalohej të miratojë ligje retroaktive ose të legalizojë**

me efekte retroaktive praktika ose marrëdhënie ekzistuese, të cilat njihen në doktrinën kushtetuese si ligje legalizuese, por kjo ndërhyrje duhet të justifikohet nga interesi publik dhe kusht për miratimin e këtyre ligjeve, që legalizojnë praktika ekzistuese, është që ato të mos shkelin autoritetin e vendimeve të formës së prerë të gjykatave (shih vendimin nr.31, datë 18.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese). 16. **Gjykata thekson se ligji i ri nuk mund të ndërhyjë në ato marrëdhënie juridike të cilat janë zgjidhur me vendim të formës së prerë, pra midis ligjit të ri dhe çështjeve që përbëjnë res judicata nuk mund të ketë lidhje juridike.** Në rastin në shqyrtim, në këndvështrimin e respektimit të parimit të sigurisë juridike, nuk konstatohet që qëllimi i ligjvënësit të ketë qenë miratimi i një ligji specifik ad hoc me qëllim që të influencojë në përfundimin e një çështjeje që është duke u shqyrtuar para gjykatës, apo rregullimi me efekte prapavepruese i marrëdhënieve që kanë lindur para hyrjes së këtij ligji në fuqi.18.**Ligji i mëvonshëm nuk lidhet me përcaktimet që ka bërë më parë praktika gjyqësore përderisa, siç u përmend më sipër, në bazë të nenit 145 të Kushtetutës gjyqtarët i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve, duke respektuar hierarkinë e burimeve të së drejtës.** Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se **midis ligjit të ri dhe çështjeve që përbëjnë res judicata nuk mund të ketë lidhje juridike.** Pra, në asnjë rast nuk mund të çenohet autoriteti i vendime të formës së prerë dhe ndryshimet e ligjeve nuk mund të përbëjnë shkak për rishikimin e vendimeve, në të kundërt do çenohej parimi i sigurisë juridike.

48. Gjithashtu, në vendimin Nr. 35, datë 20.12.2015 të Gjykatë Kushtetuese ndër të tjera thuhet se: **“Gjykata Kushtetuese thekson se parimi kushtetues i fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues duhet respektuar menjëherë nga të gjitha gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, mjafton që fati i çështjes të mos jetë vendosur ende përfundimisht prej tyre. Pra, sigurisht që ky parim duhet të respektohet edhe në gjykimin që mund të zhvillohet në Gjykatën e Lartë, sepse është pikërisht kjo gjykatë që kontrollon mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta. Pasi çështja është gjykuar përfundimisht nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, nuk ka më vend për aplikimin e parimit të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues. Në këto kushte, ai nuk mund të përbëjë as shkak për rishikimin e çështjes nga këto gjykata.”**³³ Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se në respektim të parimit të sigurisë juridike kur një çështje ka përfunduar me vendim të formës së prerë nuk mund të aplikohet as ligji që është favorizues për të dënuarin, për rrjedhojë nuk ka sens logjik dhe juridik për t’u aplikuar një ligj që është disfavorizues.

49. Duke mbajtur parasysh analizën sa më sipër, Gjykata vlerëson të theksojë se vetëm miratimi i një ligji të ri apo ndryshimi i një ligji ekzistues nuk përbën provë penale në kuptim të nenit 149 të K.Pr.Penale. Kjo pasi miratimi i një ligji të ri apo ndryshimi i një ligji ekzistues nuk shërben si e dhënë, fakt apo rrethanë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë

³³ Shih edhe Charrier “Code de la Convention Europeene des Droits de L’homme”, Paris 2000, f.140. si dhe praktikën dhe legjislacionin francez në “Legalite des delits et des peines” – un article de Eëkiberal, Encyclopedie gratuite consacree au liberalisme-2005, f.5

tij. Gjithashtu, në respektim të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, në asnjë rast nuk mund të çenohet autoriteti i vendime të formës së prerë dhe ndryshimet e ligjeve nuk mund të përbëjnë shkak për rishikimin e vendimeve, në të kundërt do çenohej parimi i sigurisë juridike.

3. Lidhur me pretendimin për parashkrim të ndjekjes penale.

50. Duke mbajtur parasysh se insitutit i revokimit të vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes ka për qëllim rishikimin e çështjes së përfunduar me vendim të formës së prerë, për ndreqjen e gabimit gjyqësor në dhënien e drejtësisë, Gjykata e merr në vlerësim kërkesën e organit të akuzës edhe në këndvështrimin se nëse kjo kërkesë pranohet a është e aftë ajo që të sjelle më pas ndreqjen e një gabimi të mundshëm në dhënien e drejtësisë. Kjo pasi neni 329/c pika 3 dh 4 i K.Pr.Penale parashikon: “3. ... Kur vendos pranimin e kërkesës, gjykata revokon vendimin e pushimit dhe i kthen aktet prokurorit, i cili rifillon hetimet. 4. Në përfundim të hetimeve, kur nuk procedon sipas neneve 328, 329/a, 406/a ose 406/dh, të këtij Kodi, **prokurori paraqet në gjykatë kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq**”.

51. Pra, nga interpretimi i dispozitës ligjore si më sipër arrijmë në përfundimin se nëse gjykata vendos pranimin e kërkesës, revokon vendimin e pushimit dhe i kthen aktet prokurorit i cili rifillon hetimet. Nëse në përfundim të hetimeve nuk procedohet sipas neneve 328 - 329/a (paraqitja e kërkesës për pushimin e çështjes), 406/a (kërkesë për miratimin e urdhërit penal) ose 406/dh (gjykimi me marrëveshje), të K.Pr.Penale prokurori paraqet në gjykatë kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq. Lidhur me gjykatën kompetente për shqyrtimin e kërkesës së revokimit të vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes neni 329/c i K.Pr.Penale, sanksionon se është përsëri i njëjti gjyqtari i seancës paraprake ai që shqyrton kërkesat e mëpasshme që mund të paraqitën nga organi i akuzës si kërkesa për pushimin e akuzës ose çështjes kur procedohet për krime sipas nenit 329/a të K.Pr.Penale apo kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq. Këtë qëndrim ka mbajtur dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë³⁴ i cili në një prej vendimeve të tij ndër të tjera arsyeton: “13. *Pretendimi e gjyqtarës për moskompetencën e saj duke u referuar në nenin 15 të Kodit të Procedurës Penale nuk qëndron, pasi paragrafi i dytë (fjalialia e dytë) trajton rastet e papajtueshmërisë midis gjyqtarit që shqyrton kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake (masa sigurimi, deklaram ikje, zgjatje afati hetimi etj) me gjyqtarin e seancës paraprake, i cili shqyrton ndërmjet të tjerash kërkesën e prokurorit për pushimin e çështjes, si në rastin objekt shqyrtimi. Pra, nuk ndalon shqyrtimin për herë të dytë të çështjes në seancë paraprake, nuk ndalon të njëjtin gjyqtar të shqyrtojë të njëjtën çështje në seancë paraprake kur ajo vjen përsëri me kërkesë nga prokurori....14. Sa sipër, vlen të mbahet parasysh nga ana e gjyqtarëve gjatë veprimtarisë së tyre, se gjyqtari i seancës paraprake nuk ka asnjë pengesë për të shqyrtuar më shumë se një herë kërkesën e prokurorit për pushimin e akuzës/çështjes edhe kur ka vendosur më parë kthimin e akteve prokurorisë apo edhe kur gjykata e apelit ka prishur vendimin e tij dhe ka kthyer aktet prokurorisë.”.*

52. Duke e parë në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se nuk ka asnjë pengesë ligjore

³⁴ Shiko vendimin Nr. 144, datë 29.05.2020 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

që të verifikojë nëse në këtë çështje evidentohet ndonjëri prej rasteve të pushimit të çështjes të parashikuara nga neni 328 i K.Pr.Penale (*parashkrimi i ndjekjes penale - pretendim i ngritur nga shtetasi Fatmir Mediu në memon drejtuar gjykatës në dt. 19.07.2021*). Në këtë përfundim arrin gjykata duke pasur parasysh faktin se nuk do kishte sens logjik që të revokohet një vendim pushimi, kur sipas kuadrit ligjor gjithësesi do të vendosej përsëri pushim i çështjes për të njëjtin motiv “*ndjekja penale nuk mund të vazhdoj*” sikurse ka konkluduar Gjykata e Lartë.

53. Gjykata çmon se, subjektet e procesit penal janë të detyruara të respektojnë parimin e shtetit të së drejtës dhe atë të sigurisë juridike. Kuptimi i parimit të shtetit të së drejtës dhe sigurisë juridike është dhënë nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese. Kështu, Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj thekson, se nga parimi kushtetues i shtetit të së drejtës, buron e drejta e kujtdo, që pretendon se të drejtat ose liritë e tij janë cenuar, për një gjykim të drejtë përpara një gjykatë të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj; që kjo e drejtë nuk mund të kufizohet artificialisht dhe që zbatimi i saj nuk duhet të pengohet në mënyrë të paarsyeshme; që e drejta e individit kundër veprimeve të paligjshme të individëve të tjerë apo institucioneve shtetërore nuk duhet të mbrohet vetëm formalisht, por dhe realisht e efektivisht.³⁵ Po ashtu, Gjykata Kushtetuese e ka theksuar vazhdimisht në jurisprudencën e saj rëndësinë e parimit të sigurisë juridike si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës. Parimi i shtetit të së drejtës ku mbështetet një shtet demokratik, nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike. Siguria juridike, përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin tek sistemi juridik.³⁶

54. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese duke iu referuar jurisprudencës së saj dhe asaj të GJEDNJ-së, ka pranuar se **mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave dhe lirive të individit mund të realizohet vetëm kur ushtrohet brenda afateve të përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje. Përcaktimi i këtyre afateve nuk përbën një qëllim në vetvete, por bëhet për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe në funksion të parimit të sigurisë juridike si një nga përbërësit themelorë të shtetit të së drejtës.**³⁷

54. Gjykata çon se në kreun e VIII^{te} të Kodit Penal ligjvënësi ka parashikuar një institut më vete në lidhje me shuarjen e ndjekjes penale, të dënimeve dhe mosekzekutimin e tyre. Brenda kuadrit të këtij instituti janë përfshirë dispozita të veçanta në lidhje **me parashkrimin e ndjekjes penale (neni 66 i K.Penal)**; në lidhje me parashkrimin e ekzekutimit të dënimit (neni 68 i Kodit Penal) dhe shuarjen e dënimit ose, sikurse e ka emërtuar vetë ligjvënësi, rehabilitimin (neni 69 i Kodit Penal). Këto dispozita përmbajnë rregullimin ligjor të këtij instituti në tre aspekte të veçanta të tij. **Dispozita e nenit 66 të Kodit Penal bën fjalë për parashkrimin e ndjekjes penale me të cilin duhet kuptuar ndalimi që ekziston me ligj**

³⁵Vendimi Nr. 17, datë 19.06.2009 i Gjykatës Kushtetuese.

³⁶Vendimi Nr. 37, datë 13.06.2012 i Gjykatës Kushtetuese.

³⁷Vendimi Nr. 25, datë 10.11.2006 i Gjykatës Kushtetuese.

për të bërë ndjekje penale në qoftë se, nga koha kur është kryer vepra penale deri në momentin e marrjes si të pandehur të autorit të saj, kanë kaluar afatet e parashikuara në këtë dispozitë.

55. Pretendimi i shtetasit Fatmir Mediu ka të bëjë me aspektin e parë të institutit të parashkrimit, d.m.th.me parashkrimin e ndjekjes penale parashikuar nga neni 66 i Kodit Penal. Në këtë dispozitë parashikohet shprehimisht: *“Nuk mund të bëhen ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar: a) njëzet vjet për krimet që parashikojnë dënim jo më të ulët se dhjetë vjet burgim ose dënim tjetër më të rëndë; b) dhjetë vjet për krimet që parashikojnë dënim nga pesë gjer në dhjetë vjet burgim; c) pesë vjet për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë; ç) tre vjet për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim gjer në dy vjet burgim; d) dy vjet për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim me gjobë.”*. Gjykata çmon se, në analizë të dispozitës së parashikuar në nenin 66 të K.Penal, vëren se, objekti i masës së dënimit të parashikuar në këtë nen i referohet maksimumit të dënimit të parashikuar shprehimisht nga secila dispozitë që parashikon veprën penale. Parashikimi i një hapësire dënimi, duke filluar me një cak minimumi dhe një cak maksimumi të masës së dënimit shërben, jo vetëm për përcaktimin dhe individualizimin e sanksionit penal me parimin e fajësisë dhe realizimin e dhënies së drejtësisë, por gjithashtu edhe për përcaktimin e maksimumit të sakrifikimit të lirisë personale që mund të caktohet për cenimin e një marrëdhënieje juridike të mbrojtur penalisht nga dispozita penale e posaçme, dhe kriteri i maksimumit të marzhit të dënimit për secilën vepër përbën një baraspeshim të drejtë midis interesit publik për ndjekjen dhe ndëshkimin e veprës penale dhe ato të individit për lirinë dhe **sigurinë juridike**.³⁸

56. Gjithashtu, nga përmbajtja e nenit 66 të Kodit Penal rezulton se, afati i parashkrimit llogaritet në ditë kalendarike, sipas rregullave të përgjithshme. Afati fillon në çastin kur vepra konsiderohet e kryer dhe përfundon ditën e fundit korresponduese të plotësimit të tij. Si pikë referimi merren çasti i kryerjes së veprës dhe çasti i marrjes së personit si i pandehur. Pra, kërkesë e detyrueshme e ekzistencës së parashkrimit është plotësimi i afateve të tij në momentin e marrjes së personit si i pandehur. Bazuar në teorinë e së drejtës penale dhe në praktikën gjyqësore rezulton se, për veprat penale të qëndrueshme afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të ecë nga çasti i zhdukjes së gjendjes kriminale, ndërsa në veprat penale vazhduese afati i parashkrimit fillon nga momenti i kryerjes së veprimit të fundit kriminal të saj. Në rastin konkret, veprat penale për të cilën është hetuar shtetasi Fatmir Mediu, *“Shpërdorimi i detyrës”* parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dënohet me burgim gjer në 7 vjet, ndërsa vepra penale *“Shpërdorimi i detyrës”* në bashkëpunim, me subjekt ushtarak - kuadër komandues, parashikuar nga nenet 70/2 e 2 të Kodit Penal Ushtarak dënohet me burgim gjer në 8 vjet. Pra, nga interpretimi i nenit 66 pika “b” i Kodit Penal rezulton se, për veprat penale të *“Shpërdorimit të detyrës”* parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe neni 70/2 i Kodit Penal Ushtarak, ndjekja penale parashkruhet me plotësimin e afatit 10 vjeçar.

³⁸Shiko vendimin Nr. 44, datë 16.03.2016 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Gjykata çmon se, në rastin konkret afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon më datë 15.03.2008, që korrespondon me datën e ndodhjes së ngjarjes (shpërthimet në ambientet e ish - Brigadës së Tankeve, në fshatin Gërdec, Tiranë). Rezulton se shtetasi Fatmir Mediu ka marrë cilësinë e të pandehurit me aktin e njoftimit të akuzës dt. 11.02.2009. Këtë cilësi procedurale (i pandehur) rezulton se shtetasi Fatmir Mediu e ka humbur³⁹ në dt. 14.09.2009 kur Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 6, ka vendosur: *“Pushimin e procedimit penal në ngarkim të të pandehurit Fatmir Mediu, për shkak se ndjekja penale ndaj tij nuk mund të vazhdojë” (Gjykim me juridiksion fillestar)*. Ky vendim i Gjykatës së Lartë për pushimin e gjyqimit të çështjes nuk rezulton që të jetë prishur ose të jetë vendosur rishqyrtimi i procesit sipas parashikimeve të nenit 34/3 të K.Pr.Penale në mënyrë që ai të ketë rimarë përsëri cilësinë e të pandehurit.

57. Duke marrë për bazë datën 15.03.2008 (data e ndodhjes së ngjarjes), Gjykata çmon se, në rastin konkret, është parashkruar ndjekja penale pasi ka kaluar afati 10 vjeçar i parashikuar nga neni 66 shkronja “b” i K.Penal. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin Nr. 7, datë 11.10.2002 lidhur me institutin e parashkrimit të ndjekjes penale dhe të ekzekutimit të vendimit penal ka theksuar se: *“Kolegjet e Bashkuara të Gjyqesës së Lartë arrijnë në përfundim se edhe duke u nisur nga interpretimi logjik i shprehjes së përdorur nga ligjvënësia në dispozitën e këtij neni ku thuhet: “Vendimi i denimit nuk ekzekutohet kur nga dita që ka marrë formë të prerë kanë kaluar...”, nuk mund të ketë zgjatje të afateve të parashkrimit të ekzekutimit të denimit për asnjë shkak...”*. Pra, edhe pse shtetasi Fatmir Mediu ka marrë cilësinë e të pandehurit nga data 11.02.2009 deri në datën 14.09.2009, Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale nuk parashikon ndonjë dispozitë për ndërprerjen ose pezullimin e afatit të parashkrimit të ndjekjes penale.

58. Nga sa u pasqyrua më sipër, Gjykata çmon që të evidentojë se edhe pse Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në të dy vendimet e tij ka theksuar se të drejtën për të kërkuar autorizimin për procedim sipas ligjit e ka vetëm prokurori,⁴⁰ nga tërësia e akteve procedurale dhe e provave që ndodhen në dosjen gjyqësore konstatohet se që prej datës 14.09.2009 (data e shpalljes së vendimit të pushimit nga Gjykata e Lartë) e në vazhdim, organi i akuzës nuk i kërkoi përsëri Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj ish - deputetit Fatmir Mediu, mungesa e të cilit nuk lejonte vazhdimin e procedimit penal. Gjithashtu, Gjykata çmon që të evidentojë se edhe pse kuadri kushtetues dhe ligjor përcakton se deputeti nuk gëzon imunitet parlamentar për ndjekjen penale apo gjykimin e tij konstatohet se që prej vitit 2012⁴¹ e në vazhdim (më shumë se 8 vjet), organi i akuzës nuk ndërmoi hapat e

³⁹ Neni 34/2 i K.Pr.Penale përcakton se: *“2. Cilësia e të pandehurit ruhet në çdo gjendje dhe shkallë të procesit derisa të ketë marrë formë të prerë vendimi i pushimit, i pajfjësishë ose i denimit. ...”*.

⁴⁰ Neni 288/1 i K.Pr.Penale me titull *“Autorizimi për të proceduar”* i cili ka qënë në fuqi në kohën e gjyqimit të çështjes përcaktonte: *“1. Kur parashikohet autorizimi për procedim, prokurori bën kërkesë në organin përkatës. 2 ...”*.

⁴¹ Viti kur me ligjin nr. 88/2012 *“Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, dt. 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar, ligjvënësi i hoqi deputetit imunitetin parlamentar për ndjekjen penale apo gjykimin e tij.

nevojshëm sipas ligjit për ushtrimin e ndjekjes penale megjithëse tashmë nuk ishte më e nevojshme që të kërkohej të jepej autorizimi nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Pra, nga vitit 2012 deri më datë 1 Gusht 2017 kur hynë në fuqi ndryshimet e K.Pr.Penale me Ligjin Nr. 35/2017, prokuroria nuk ka pasur asnjë pengesë që të rimerte të pandehur shtetasin Fatmir Mediu pa kërkuar autorizim për ndjekje penale apo të kërkonte rishikim të vendimit. Në kushtet kur prokuroria nuk e ka ushtruar ndekjen penale për një periudhë mbi dhjetë vjet edhe pse nuk ka pasur një pengesë të tillë, Gjykata çmon se ajo nuk mund të ushtrohet më tashmë bazuar në nenin 66 gërma “b” të Kodit Penal dhe në nenin 328 pika 1 gërma “d” të K.Pr.Penale.

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Gjykata bazuar në nenin 112 dhe 329/c të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S I :

1. Rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim nga Prokuroria, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 15 ditëve, afat i cili fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.

U shpall në Tiranë sot më datën 27.07.2021

**GJYQTAR
ERJON ÇELA**